

Festivali Ndërkombëtar i Poezisë  
"Ditët e Naimit"

Biblioteka  
**MERIDIANE POETIKE**

Përgatiti  
**Shaip EMËRLLAHU**

Këshilli botues  
**Ymer ÇIRAKU**  
**Agron TUFA**  
**Niels HAV**  
**Ndue UKAJ**  
**Haxhi Shabani**  
**Artan ARSLANI**

Përktheu  
**Silke Liria BLUMBACH**

Ballina  
**Iliriana ZHUTA**

Ilustrimet  
**Sali LUTOLLI**

[www.ditetenaimit.org](http://www.ditetenaimit.org)

Festivali Ndërkombëtar i Poezisë  
“DITËT E NAIMIT”

Edicioni XV

## RIZGJIMI I LUTJES



Ditët e Naimit  
Tetovë, 2011



## DITËT E NAIMIT MODEL I NDËRKOMUNIKIMIT LETRAR E KULTUROR

Letërsia dhe kultura në përgjithësi, ndër vite kanë njo-  
hur modele dhe tipe të ndryshme ndërkomunikimi. Këto  
nivele dialogimi, të cilat kanë qenë shumështrësore, kanë  
bartur peshën e zhvillimit dhe afirmimit letrar e kulturor.  
Në dhjetravjeçarët e fundit, ato formate komunikimi janë  
begatuar, duke bërë që plotënia e polivalencës, polifonisë,  
polisemisë dhe e shumështrësimit të veprave letrare, pra e  
botës së veprave kulturore në përgjithësi, ngado që ta ketë  
origjinën, të shkojë te recepti (publiku).

Në mesin e shekullit XX nisën proceset integruese në  
kointinentin tonë dhe më gjerë. Tendencat e globalizimit  
morën formë të qartë në projektin - Identiteti evropian.  
Arkitektura e Bashkimit Evropian u frymëzua kryesisht nga  
kultura e etnive të saj, nga trashëgimia e diversitetit kul-  
turor. "Krerët e shteteve dhe qeverive, kulturën e quajnë si,  
themelin kryesor të Evropës, e cila përcaktohet më pak nga  
gjeografia, se sa nga vlerat e përbashkëta që i bashkon  
popujt e saj." Ndërkaq, artizani i ndërtimit evropian Denis  
de Rogemont, i cili kuptimin e nocionit kulturë e ka më  
të gjerë, shprehet se, "kultura është bashkimi i ëndrrave  
dhe punëve, të cilat synojnë realizimin e plotë të njeriut.  
Kultura kërkon të arrijë këtë marrëveshje paradoksale: të  
ndryshojë parimin e bashkimit, të thellojë dallimet, jo për  
t'i ndarë ato, por për t'i përmirësuar më tepër. Politikat  
kulturore, gjithnjë e më shumë gjejnë vend në politikat e të  
ardhmes evropiane. Në frymën e globalizimit, deri më sot,

janë miratuar deklarata të shumta dhe po implementohen programe kulturore disavjeçare, me qëllim të ngritjes së strategjive dhe gjetjes së teknikave të ndërkomunikimit kulturor. Ndërkaq, mekanizma të ndryshëm të Bashkimit Evropian në qendër të veprimtarive të tyre kanë projektuar dialogun ndërkulturor, këmbimin e përvojave "promovimin e identitetit evropian përmes promovimit të dallimeve kulturore".

Kështu, një model i promovimit të diversiteteve, të ndërkomunikimit letrar e kulturor është edhe ai i festivaleve ndërkombëtare. Ato kanë qenë dhe vazhdojnë të jenë edhe tani një arenë, ku dialogohet nga afër në nivel subjekti letrar dhe kulturor, në nivel prodhimi letrar, gjuhësor dhe të atij etnik. Tek ata ekzistojnë hapësira përkatëse për të ngritur urat e një bashkëpunimi ndërkulturor, për të këmbyer përvojat dhe informacionet në mes artistëve, poetëve, njerëzve të muzikës etj, por, edhe në mes të operatorëve të ndryshëm kulturor. Festivalet paraqesin shenjë e një lëvizshmërie të përbërësve të strukturës së trashëgimisë dhe të diversitetit kulturor. Ata janë një kuvend, i një ndërkomunikimi shpirtëror e frymor, i një kryqëzimi të pririjeve dhe rrezatimeve të vlerave të zhvillimit të popujve nga qytetërimi të ndryshme. Ta riafirmojmë, të diturën, se, "Kultura, ndodhet në zemër të qytetërimit dhe zhvillimit njerëzor". Kualiteti i qytetërimit, ndikohet nga performanca e ndërtimit të një bashkëbisedimi, pra, "nga cilësia thelbësore e kuvendimit frymor dhe shpirtëror". "Shpirti i një populli, thotë Alen Boske, pasqyrohet në poezinë e tij, më mirë se, në çdo formë tjetër të artit". Dialogimi i eksperiencave, koncepteve e ideve letrare të popujve të ndryshëm, përmes takimeve letrare dhe kulturore të formatit të një shënjesi kulturor e letrar, shpërfaq më së miri ngecjet dhe ecuritë përkatëse të tyre.

Një model i këtillë i ndërkomunikimit bashkëkohor letrar e kulturor është padyshim edhe Festivali Ndërkombëtar i Poezisë "Ditët e Naimit" me seli në Tetovë. Ai u ngrit para 15 vitesh për të përkujtuar figurën e poetit tonë kombëtar. U ideua në frymën e ndërtimit të një komunikimi e dialogimi brendashqiptar, i cili ishte prerë me kufi getiozimi të totalitarizmit komunist dhe atij të hegjemonizmit sllav. Ky projektshënjesi kulturor paraqiste një sprovë, ku do të vendoseshin pranë e pranë subjekti letrar e kulturor në përgjithësi, dhe letërsia shqipe, përkatësisht poezia shqipe në veçanti, si një dhe e pandarë në një dialogim mes veti dhe me vonë me atë të huajën. Takimi letrar i Tetovës, shenjoji rinjohjen mes vete, pra, aty u promovua ndërkomunikimi i shumëmunguar brendashqiptar. Më vonë, ky komunikim u zgjerua jashtë kufijve të arealit letrar e kulturor shqiptar. 'Ditët e Naimit', thotë njëri nga themeluesit e këtij institucioni, A. Selmani, udhëhiqet nga një synim i këtillë, duke thyer barrierat pak nga pak, të arrijë atje ku është vonuar letërsia shqiptare, të paktën t'i hapë dyert dhe t'i krijojë këto mundësi ndërkomunikuese me botën...".

Në fjalët tona të hapjes së edicioneve të Festivalit Ndërkombëtar të Poezisë 'Ditët e Naimit', vazhdimisht kemi nënvizuar dhe afirmuar vlerat e ndërkomunikimeve bashkëkohore letrare e kulturore që kanë reflektuar 15 edicionet e këtij shenjuesi kulturor, i cili çuditërisht flet nga cepi i gjeokulturës sonë, Tetova. Mbase, kjo është edhe një tregues se, aty ku ndodh ndeshja e diversiteteve, kjo formë komunikimi favorizon shkëputjen nga "rrethi vicioz i provincializmit dhe izolimit kulturor", rimbursor rrjedhjet dhjetravjeçare në këtë drejtim, si dhe paraqet formën e vetëdijes sonë globaliste për të komunikuar, ruajtur dhe afirmuar identitetin tonë kulturor e shoqëror.

Festivali Ndërkombëtar i Poezisë "Ditët e Naimit" është operatori i parë poetik dhe kulturor, i cili në krye të herës, e gjykoi si të domosdoshme rivendosjen e një infrastrukture moderne ndërkomunikimi me kulturën dhe letërsinë e huaj, (pra me subjektin poetik dhe me vetë poezinë botërore). Ky festival, thotë prof.dr. Ymer Çiraku "ka marrë dimensionin e një institucioni të shquar kulturor, (... ) aktivitet ky, ku takohen jo thjesht poetët e vendeve të ndryshme të botës, por para së gjithash, kulturat e popujve, si dëshmi komunikimi, njohjeje e stime reciproke. Ai u bë prurësi dhe përhapësi i llojit të vet të multikulturalizmit, ku kryefjala është poezia, kjo "formulë magjike që i lidh njerëzit dhe popujt".

Ismali Kadare, pas përfundimit të edicionit të VI të Festivalit, (ku u lauria me çmimin e madh letrar 'Naim Frashëri'), do të deklarojë, se "Duke parë ate pjesëmarrje të gjerë të poetëve që vinin nga vende të ndryshme u pa qartë prirja për hapje drejt Evropës dhe botës. Kultura shqiptare dhe vetë kujtimi i Naimit të Madh, të gjitha këto bëjnë pjesë në qytetërimin evropian".

Në këtë aktivitet të përvitshëm kulturor, i cili ngritet mbi një program të larmishëm të artit poetik, pamor, muzikor, e skenik vijnë dhjetëra poetë, piktorë, këngëtarë, aktorë të skenës dhe botues nga vende të ndryshme. Aty përmes aktiviteteve të shumta dhe të ndryshme brenda një edicioni, shpalosen vlerat e botës së artit dhe kulturës shqiptare, por edhe të asaj botërore. Janë një sërë performancash të leximeve letrare, përrime të librave të poetëve pjesëmarrës të botuara nga shtëpia botuese e festivalit, pastaj debate mbi letërsinë dhe artin në përgjithësi, sesione shkencore, ekspozita të pikturave dhe skulpturave të autorëve shqiptarë dhe të huaj, revy e valleve dhe veshjeve kombëtare shqiptare të regjioneve të ndryshme, ekzekutime të koreve, interpretime të instrumentistëve, të këngëve folklorike dhe të muzikës klasike shqiptare, shfaqje teatrale, recitime të vargjeve të ndryshme të poetëve shqiptarë dhe atyre të huaj, vizita nëpër muze e monumente kulturore e fetare të qyteteve të ndryshme shqiptare, pastaj afirmimi i figurës dhe veprës së poetit tonë të madh Naim Frashëri, (emrin e të cilit e mban festivali), përmes ngritjes së shtatores së tij në qendër të Tetovës, organizimit të sesionit shkencor e botimit në një libër të punimeve të tij në 100 vjetorin e

vdekjes, ndarjes së disa çmimeve që mbajnë dhe lidhen me emrin e tij, (si çmimi i madh 'Naim Frashëri', 'Qiriu i Naimit', dhe 'Ditët e Naimit'), pastaj botimi i një kolane të gjërë librash të autorëve shqiptarë e të huaj, botimin e përvitshëm të antologjisë së poetëve pjesëmarrës (dy antologji edhe në gjuhë të huaja), katalogjet e ekopozitave të artit pamor, broshura e pankarta, ueb faqja e Festivalit etj., të cilët flasin për gamën e gjerë të shumsorësisë, shumëkuptimësisë, shumëzërësisë dhe shumëvlerësisë së ndërkomunikimeve të rrafsheve kulturore të këtij shenjuesi të madh e të rëndësishëm poetik e kulturor të shqiptarëve.

Pjesa kryesore e programit të Festivalit, zhvillohen në salla të kulturës dhe në amfiteatro të universiteteve, përplot me artdashës. Ndërkaq, hapjet si dhe mbylljet e Festivalit, që brenda vetes mbajnë një program me shumësi ngjarjesh kulturore, e që zhvillohet në një transmetim të drejtpërdrejtë televiziv paraqesin një komunikim më të gjerë me publikun dhe shikuesin. Kështu, në këtë shenjues ndërkombëtar letrar e kulturor, ndërkomunikimi ndodh në disa rrafshe. Njëherë, brenda vetë poetëve, pjesëmarrësve dhe arteve të tyre, pastaj në mes tyre dhe publikut shqiptar. Publiku dialogon drejtpërsëdrejti me poetët. Ai, ka mundësinë e mirë të komunikimit edhe me poetikën, pra me vlerat artistike e estetike të lirikave të autorëve, herë në gjuhët origjinale të krijimit përmes leximit nga vetë poetët, e herë në gjuhën shqipe, përmes deklamimit nga ana e aktorit. Këtë komunikim me botën letrare të tyre e bën më të lehtë edhe antologjia e botuar e poezive të pjesëmarrësve, që publikut i servohet falas para fillimit të festivalit. Kjo antologji, e cila përmban, përveç poezive, shënime biografike, fotografitë e poetëve, ilustrime e piktura të shkollave të ndryshme të piktorëve, edhe parathënie nga kritikë dhe studiues të letërsisë, të cilët theksin e vendosin në rolin dhe rëndësinë që ka ky institucion letrar e kulturor në afirmimin e poezisë e kulturës shqiptare dhe të huaj, në këmbimin e përvojave dhe informacioneve, në dialogun ndërkulturor dhe në promovimin e diversiteteve kulturore. 'Në të gjitha antologjitë e botuara poetike të krijuesve pjesëmarrës, (...) është krijuar një bibliotekë e vyer dhe serioze, ku mund të hetohen tendencat dhe rrugëtimet estetike të poezisë së sotme botërore'. Kështu, pra ajo mundëson hetimin më të lehtë dhe më të shpejtë të shenjave universale e sistemin tematik e motivor të ligjëritimit, mitet e legjendat, kompozicionin, figurën dhe stilin, sistemin e vargënimit etj. Jep një pasqyrë të shënimeve mbi autorin dhe veprën e tij etj.

Në 'Ditët e Naimit', kemi edhe një tip komunikimi, i cili ndodh përmes përkthimit të letërsisë së huaj në gjuhën shqipe dhe anasjelltas. Këto përkthime vijnë nëpërmjet publikimeve të veçanta, si dhe përmes botimit të antologjive të poezisë së poetëve pjesëmarrës. Botimet elektronike, janë gjithashtu, një tjetër mënyrë komunikimi e poezisë së poetëve, të cilët gjatë tërë vitit janë në dispozicion të lexuesit faqen e internetit. Poetët, theksuam më lartë se, realizojnë sipas programit vizita në qytete, ku ta-



kohen me qytetarë dhe veprimtari të tyre. Ata, njihen dhe marrin informacione mbi kulturat e ndryshme, por edhe ndikojnë në mënyrën e tyre të jetuarit. Pra, kemi ngritje të një komunikimi të drejtpërdrejtë me botën shqiptare dhe të tjerëve të atij nënqielli. Poeti i ndjerë danez, Erik Stinus, i cili së bashku me gruan e tij poete nga India dy herë ka qenë në Tetovë, pat deklarur, se "Ne jemi familjarizuar pak më shumë me popullin që na mirëprit, me letërsinë e tyre, këngët e tyre, kulturën dhe historinë e tyre. Kjo përvojë do të duhej t'u garantohej të gjithë njerëzve - se sa i ngajnë vetes së tyre". Gjithsesi, në anën tjetër, "ky festival ka përcjellë natyrshëm dhe jehonën e poezisë e të kulturës shqiptare në këto vende, në të katër anët e rruzullit". Pra, ata kanë objektivuar botën shqiptare, në poezi, cikle poezish e vëllime të tëra, në tregime e romane, të cilat i kanë publikuar në gjuhët e tyre.

E gjithë kjo që thamë më lartë, provon se letërsisë, kulturës dhe qytetërimit tonë, me hapa të përshpejtuar i është dashur të rivendosë urat tradicionale të shkëputura të komunikimit me botën. Ndonëse, nën rregullat e frymës së hapjeve dhe të integriteteve, kjo infrastrukturë ekzistuese e shkëmbimeve kulturore e letrare nuk është më, aq funksionale. Sot, ato formate komunikimi kanë evoluar, siç kanë ndryshuar edhe sisteme e kode të tjera të ecurisë së zhvillimit të njerëzimit, duke iu përshtatur tendencave të reja, të cilat na i imponon epoka e botës së dialogimit dhe e frymës integruese, pra e asaj të globalizimit. Në dritën e një formatimi të ri global, këtyre modeleve të interkomunikimit iu nevojitet një rishikim, pra një kod që do t'iu përgjigjet kërkesave, të cilat i dikton kjo epokë unifikuese.

Cila është vetëdija, sa ekziston gatishmëria dhe sa arrijmë ta akceptojmë nevojën e modifikimit të këtyre modeleve ndërkomunikuese, kur sa vjen e dëshmohet edhe përmes këtyre festivaleve poetike, se "poezia (letërsia - SH.E.) është një mjet interkomunikues dhe interkulturor, që mund të shfrytëzohet racionalisht dhe praktikisht edhe në këto kushte moderne, kur flitet për një frymë globale".

Mr. Shaip EMËRLLAHU



Fitues i çmimit letrar “Naim Frashëri”  
**Craig CZURY (SHBA)**



## Craig CZURY (SHBA)

U lind më 10 mars 1951 në Kingston, Pennsylvania, SHBA. Ai u rrit në një zonë të pasur me qymyrgur në Pensilvaninë Verilindore. Kaloi 15 vjet duke i rënë pash më pash Amerikës së Veriut, duke punuar në karnavale, ndërtim, kuzhina restorantesh. Ka organizuar lexime të shumta publike poezish. Craig Czury ka marrë titullin M.F.A. (Master i Arteve të Bukura)



nga Universiteti Wilkes dhe është lektor në Kolegjin Albright. Ai punon edhe si poet në shkolla, në azilet e të pastrehëve, burgje, spitale për të sëmurët mendorë dhe qendrat komunitare në të gjithë botën.

Është nderuar me shumë çmime kombëtare dhe bursa ndërkom-bëtare për të vazhduar performancën e shkrirjes së poezisë dhe projektet murale poetike. Një instrumentist shumë i aftë i harmonikës. Ai është poet laureat i Kontesë së Berksit (2010-2012).

Jeton në Reading, Pensilvani. [www.craigczury.com](http://www.craigczury.com)

Ka shkruar mbi 20 vëllimeve poetike si:

-Prerje dhe tymosje, FootHills Publishing, 1989, Bath, Nju Jork.

-Përveç..., FootHills Publishing, 1990, Bath, N.Y.

-OBIT HOTEL, Pine Press, 1993, Landisburg, Pa; SCRAPPLE, Nightshade Press, 1995, Troy, Me.

-Hije/Hije jetime — SOMBRA/SOMBRA HUÉRFANA, (përkthyer në gjuhën kastelane Rosann DeCandido dhe Alicia Partnoy) Pine Press, 1997, Landisburg, Pa.

-Fytyra të papajtuara, FootHills Publishing, 1999, Bath, N.Y.

-PARALLEL´NOYE TECHNIE / Rrjedhë paralele, (përkthyer në rusisht nga Irina Mashinskaia) Petropol Press, 1999, Shën Petërburg, Rusi.

-Në mbyllje e sipër, FootHills Publishing, 2000, Bath, N.Y.

-FACES IRRECONCILIÁVEIS / Fytyra të papajtuara, (përkthyer në portugalisht nga Narlan Matos) Red Pagoda Press, 2002, Reading, Pa.

-ANGLIAVAIZDIS /Peisazh me qymyr, (përkthyer në lituanisht nga Marius Buroko) Vario Burnos, 2002, Vilnius, Lituani.

-OTROS POEMAS / Përvojë amerikane, (përkthyer në spanjisht nga Esteban Moore) PapelTinta Ediciones. 2003, Buenos Aires, Argjentinë.

-Përligjje me heshtjen time, FootHills Publishing, 2003, Bath, N.Y; IN ATTESA DI BREVETTO / Përvoja amerikane, (përkthyer në italisht nga Riccardo Duranti, me ilustrime nga Dino Patanè) Edizioni Empiria, 2003, Romë, Itali.

-DNEVNIK BEZ IMENA / Ditar pa emra, (përkthyer në kroatisht nga Milos Durdevic) Literature Live, 2004, Zagreb, Kroaci.

- Syri i shndritshëm prej qelqi i Zotit, FootHills Publishing, 2004, Bath, N.Y.

-Përvojë amerikane: në pritje të çertifikimit, Paper Kite Press, 2006, Wilkes-Barre, Pa.

-Kam frikë ta them, (përkthyer në shqip nga Silke Liria Blumbach) Manifestimi Letrar Ndërkombëtar "Ditët e Naimit", 2006, Tetovë, Maqedoni.

-Kuzhina e zgjidhjeve të konflikteve, FootHills Publishing, 2009, Bath, N.Y.

Është redaktor i dy antologjive, Vijë e hollë ulëritëse nga N.E. Pa. Prison Poetry Project, dhe Un Segundo en el tiempo/Një sekondë në kohë me poetët e komunitetit Reading Hispanic.

Antologji dhe kolana botimesh

Vijëza ulëritëse: Antologji e Poezisë së Burgut nga N.E. Pennsylvania. Endless Mountains Review Press, 1992.

UN SEGUNDO EN EL TIEMPO / Antologia de poesía Berks y más allá / Një sekondë në kohë: Antologji poetike e Berksit dhe më tej. Albright College Press, 2002. Kolana e poetëve të Montanës, Gjashtë libra nga poetët e Montanës. FootHills Publishing, 2010.

Kolana e poetëve të Montanës, Vëll. 2, Gjashtë libra nga poetët e Montanës. FootHills Publishing, 2012.

Ka përkthyer librat: L. Jakimavičius MEDINE / Prej druri. Versioni nga lituanishtja në anglisht nga Craig Czury, me Alma Valevičiene. Përkthyer gjithashtu prej Laima Sruoginis, Mara Almeniene, Galina Čepinskiene. Botimet e Lidhjes Lituanëze të Shkrimtarëve, Vilnius, 2001. A. A. Jonynas, LAIKO INKLIUZAI / Përfshirje në kohë. Versioni nga lituanishtja në anglisht nga Craig Czury. Përkthyer gjithashtu prej Antanas Danielius and Jonas Zdany. Botimet e Lidhjes Lituanëze të Shkrimtarëve, Vilnius 2002.

Sh. Emërllahu, LIFE'S RAGS, versioni nga shqipja në anglisht nga Craig Czury, me Elvana Zaimi-Tufa, Manifestimi Letrar Ndërkombëtar, 2009, Tetovë, Maqedoni.

## ARTICULITUS TË NDRYSHËM

ka diçka të paepur nën cipën e  
një fjale që s'e kam përdorur më parë

poezia gjuha e mbrame para vdekjes

~

e dy shkollave

që shkruajnë atë që unë s'di më intereson më shumë

~

diku mes vështrimit dhe shikimit

duket sikur s'e kam mendjen aspak

ndëshkimi është i ashpër

~

ende mendon se kujtesa

ka ndofarë lidhjeje me të menduarit

~

ç'gjë tjetër në këtë bukuri të tejdukshme

në cilin çast

~

largësia mes leximit dhe vizualizimit

tërthorësi

tashmë ti di si të mos hapësh sytë

~

gjithë këto fjalë për kujtesën

kemi qenë të dy atje

e prapë, rrëfimi yt e rrëfimi im

~

ai vështrim i çuditshëm

më çon teposhtë gjuhës

ai vështrim i humbur i pagjetur kurrë më

~

mes asaj që kujtoj

dhe asaj çka kam përfytyruar

~

vjen ç'prej vdekjes të më tregosh

~

i dallueshëm në zgrip

~

nuk besoj në një poezi të shkruar

nga një mendje e vetme

as unë

~

bastet anojnë nga kripa e detit  
gjak që shpërthen brenda gjakut

## VELENXË E BARDHË

(për Rexhinën)

po për vdekjen e çdocilës fjalë  
më duhet të bart këtë velenxë të faqes së bardhë

nënkresë e bardhë e faqes  
që më prin kah [poezia?]  
hapësira luksoze  
ku të prehen sytë e mi

~

aq qetë sa të dëgjosh  
të shohësh ç'dëgjohet përtej  
s'ka fare lidhje me mendimin

~

gjuhë private shkruar me një shkrim dore të fshehtë

~

ky tension i bardhë i tendosur i heshtjes  
që fjalët e mia të fliten vetiu

~

por si të mos e fshij vetveten  
në qesharakësinë e  
bojës lëng balsamosës i  
fjalëve sarkofag  
i mendimit vdekje e  
dijes

qesharake

~

po nëse kur përshëndetemi  
të flasim poezi  
po sikur gjuha jonë e mbërritjes  
të shpërbëhet në rrokje të thella shikimi  
shikimin e njëri-tjetrit si në një çast të parë ngazëllyes  
po kur të nisemi?

sikur të mos takohemi më kurrë

~

çnjerezore dhe e paturpshme  
të thyesh ëndërrsinë e mendimeve të tua mëngjesore  
të lexosh një gazetë

~

për aq rrallë sa të shoh  
vdekja jote me mua është në rregull  
e di që përherë je aty ku duhet të jesh  
biseda jonë vazhdon



shikimi që më hedh vazhdimisht prin/qorton  
~  
shtriqu në plazh  
    jam horizonti  
shtriqu në shtratin tim të rërës  
    piskamë pulëbardhash dallgët që rrokullisen  
me forcë  
sikur horizonti, edhe unë do të mbetem përgjithnjë

## MES LUTJES DHE ZGJIMIT

mes kësaj filigrane psalmesh  
arrij dhe nxjerr  
zërin tënd të njëzet viteve më parë  
që pyet ku është qendra ime

mes lutjes dhe zgjimit  
iluzioni këmbëngulës i zgjimit  
pa i lëvizur buzët  
vetëm se nuk po fle më  
palindrom uji  
kur një zë qërohet  
të tjerët sajojnë  
inkremente tingulli  
me interval muri shpërbëhet  
një gjësend blu mes nesh  
vazhdoj ta humbas vendin tim  
tierra sagrada s'e them dot tamam  
nëse qeshë unë që udhëtova  
nga vdekja apo t'i tregoja vetes  
këtë pyetje një gjë të tillë si e kaluara

~  
mes lutjes dhe zgjimit  
rizgjimi i lutjes  
për të përfshirë këtë hapësi  
sikur vëmendja të përqendrohet përtej  
ti do të thoshe jo besueshëm  
nën sipërfaqe diçka nuk shkon  
frymëmarrja që është shumë larg  
e padukshmja e dashur e ashtuqajtur më afër  
e harroj shtrembërimin  
vetë emri im në gjithçka  
ky vështrim për orë të tëra i vetmuar

~  
çdocila fjalë duhet ëndërruar  
para se të bëhet poezi

po kush nga ne mund ta dijë  
 fillimin në këtë gjysmë-dritë  
 mes poetit dhe asketit  
 pasi dikur ke frymëmarrë përtej  
 si për të parë, edhe për t'u mbushur  
 vetëm i shkolluari i pandriçuar do të thoshte  
 metafora muzika e lustruar  
 kur diçka horizontale në errësirë lëviz  
 s'ka fare kohë të shkosh ta shohësh në sy

~  
 kundërthënia e zgjimit  
 mes shikimit dhe thënies  
 çka shihet nga heshtja  
 nëse ka ndonjëherë heshtje  
 fillon të tregosh me sytë mbyllur

~  
 ka një derë  
 dhe një hije që mendon se është fytyrë  
 në pasqyrën pas derës  
 ti e di që ka mace  
 por e vetmja syresh ka dalë jashtë me kohë  
 s'e sheh dorën kurrë  
 vetëm pasqyrën që mendon se është fytyrë  
 drita gjithmonë ndezur në korridor  
 ajo kruarje pas çimentos së lagësht

~  
 mes lutjes dhe zgjimit  
 gjuha hermetike e lutjes  
 kur kërcehet fshin këmbët  
 si ngjyra të pikturuara nga sytë  
 kur flitet fshin lutjen  
 membranë e hollë lëkure  
 mes tingullit imazhit ligjëratës  
 kjo poezi një hartë rrëzon pingul

~  
 gjuha e flakshme e zgjimit  
 muri varet mes kornizës së vet  
 pa bisedë heshtjeje  
 dhe kohën që duhet për t'u çmontuar  
 i humbur shpërbërë me ç'gjuhë  
 pastaj tamburët duron  
 në pyll me askënd

~  
 Infuzion i kundërt i lutjes  
 drejtuar nga vdekja  
 ose pasqyra e saj errësira fle  
 drita ngurron dhe bluan  
 kah një shikim i ngulmët pas syve

~

mes lutjes dhe zgjimit  
 con(tra)versación  
 mes një gruaje dhe një burri  
 që i flasin njëri-tjetrit  
 përgjatë një pengese të lehtë  
 që dredh laqe të shtrënguar  
 rreth asaj çka kurrë s'është thënë zëllartë  
 zë – harxhojmë tërë jetën  
 duke rrjedhur jashtë gjithë tingullit  
 të tepër për të shkaktuar zhurmë kafshe  
 jam ulur në zgrip të një heshtjeje të stërmadhe  
 në pritje që heshtja jote të më kthejë vitet mbrapsht.

## PRA, NË FUND MBETET PERCEPTIMI

pak shenjtëri mes gjithë profanizmit dhe mediokritetit  
 kur dëgjon veprimin që bën tek i dorëzohesh qëllimësisë  
 duhet të kthehesh anës tjetër e të jesh pas syve të tjerë  
 tek tretesh në ato vende në zgrip të pamjes e vështrimit  
 vendi dhe pikëmbërritja përkohësisht s'janë aspak të mundshëm  
 tek luajnë me dekorimet lulore  
 mu sikur loçkat e syrit gjethe të ishin e të lëshohej  
 duarsh një erë e fortë  
 s'do ta dije ku qëndron, duke rrotulluar fjalët derisa të jenë të duhurat  
 mund të jetë një vend ku njerëzit mblidhen sipas një tonaliteti zëri  
 dua të dëgjoj dikë të flasë që të prapësojë me njëmend zhurmat në sfond  
 në mes të gatitjes hollësisht më shpëtojnë

## HAP NJË HESHTJE TË TMERRSHME MES NESH

mas trashëgiminë në një ton zëri  
 nën atë farë vështrimi  
 Ç'ishte ajo gjë që na u premtua  
 një gjest i veçantë i tërhequr mbrapsht  
 Nga çfarë gjëje u desh të hiqnim dorë

dikush diku që mund ta njihnim shumë kohë më  
 parë  
 Në ç'vend të Biblës shkruhet pakushtëzueshëm  
 lexova gazetat  
 Mos po të hante diçka  
 prej asaj çka herën e fundit s'e more  
 Këtu  
 të jap gjithë çka kam gjetur qysh se isha djalë  
 capak fjalë të mezipërdorshme dhe këtë çast leximi

## E SHTUNA E VDEKUR

Po as në një varrezë nuk mund të hash pa muzikë  
 kamerieri sapo solli një pjatë kërpudha skare salcë  
 shishe verë të kuqe  
 jam vjerrë pas palltos së mbështjellë fort duke ngro-  
 hur gishtat në llambën me kandil  
 buzët puthin një gotë raki  
 dhomëza sipër, ku liqeni laton trungjet në stola frymë  
 e ftohtë avullon çdo tryezë në  
 kioskën e vet  
 çdokush prej nesh mendimet tona prekin drurin  
 qoftë dhe pragdere  
 ndërsa lexojmë poezi mbi të vdekurit të një poeti  
 tash të vdekur  
 s'jam vetëm unë që lavdërohem se jam varrezë  
 muzikantët po luajnë si dikur si një sekret i nxjerrë  
 prej mendimeve të thyera  
 violinat e tyre zgjerohen për petalet që do t'u hedhin  
 përmes kësaj drite të mugët  
 para se të ngrenë vështrimin

## ÇDO DITË NJË KËRKIM LEGJENDAR PËR BRITMËN E HUMBUR

të fëmijëve në pyll  
 çdo ditë një grua del nga shtëpia  
 shkon në pyll dhe kërkon të bijtë  
 çdo ditë dashurohet me një pemë  
 bën dashuri me të  
 dhe kthehet në shtëpi pa rënë nata  
 çdo ditë një grua del nga shtëpia  
 shkon në pyll dhe kërkon të bijtë  
 çdo ditë ajo hedh krahun rreth trungut të një peme

dhe fërkohet pas saj derisa pema dridhet  
derisa gruaja bëhet litar floku  
pastaj kthehet në shtëpi pa rënë nata  
një grua në kërkim të bijve të vet  
shkon në pyll por aty nuk ka pemë  
vazhdon të ecë nga ana tjetër  
e argjendte dhe rrëzëllitëse  
para saj zhavorri rrëzëllen

*Përktheu: Elvana Zaimi-Tufa*





## Ivan ANTONOSKI (MAQEDONI)

U lind në vitin 1990, në Shkup. Ai është autor i vëllimeve poetike: Mendime fëmijërore (Shkup: Parlamenti fëmijëve i Maqedonisë, 1999); Miqësia fëmijërore (Manastir: Klubi i shkrimtarëve Stale Popov, 2000); Hapërimet fëmijërore (Manastir IK Apeks, 2001); Përpëlitja e natyrës (Shkup, Revija Ekologia dhe MAHAJA, 2002), Edhe kur të lutja të rritesh (Makedonska reç, 2007) dhe botimi i dytë (Shkup Makedonska reç, 2008). Përmbledhja poetike më e re është botuar në gjuhën serbe dhe bullgare: Kat sam te moli oda porastesh (Nish: Qendra kulturore Nish 2008)dh Kogato te moleh da porasnesh (Melnik: IK Mellnik, 2008).

Është autorë i prozës dygjuhësore Syri i madh i Britanisë së Madhe (Shkup Makedonska reç, 2005), si dhe librin e ilustruar për fëmijë Palaçot e mia (Manastir IK Apeks,2001). Redaktor i përzgjedhjeve të materialeve folkloristike Traditional tales and legends from Macedonia (Shkup, 2008) E përkthyer në gjuhën angleze.

Poezia e tij është botuar në revistat Stozher dhe Sovremenost. Është përkthyer në: Gradina (Serbi), Irin Pirin, Noviot pulls, Sllovoto (Bullgari) dhe në Knizhevno pero (Kroaci), si dhe është përfshirë në antologji të ndryshme. Ai ka përkthyer disa përmbledhje poetike (serbisht) dhe një vepër në prozë (kroatisht).

Deri më sot ka marrë pjesë në shumë manifestime shkencore, që shumica kanë karakter ndërkombëtar, dhe pjesa dërmuese e punimeve janë të botuara nëpër revista periodike. Për të arriturat e tij të deri tashme është shpërblyer me dhurata shtetërore e ndërkombëtare.

Antonovski është bashkëpunëtorë i disa medimeve të shkruara dhe elektronike dhe është anëtar i disa organizatave joqeveritare. Prej tetorit 2009, ai është anëtar i Shoqatës së Shkrimtarëve të Maqedonisë.

## KËRCNIM POROSI, ZGJIDHNI VET

Edhe pse kah moti porositet  
që fytyrat tua zografojnë në fresk  
nëpër foltore  
në të cilët kandilat  
ndizen vetëm pas mesnate  
që në pagëzime  
këndohet salikim për meshë,  
ndërsa nëpër trupat tuaj  
të bëjnë figura të idealizuar

dhe të vënë pranë burimeve,  
 që minutat e stinëve të shurdhtë,  
 virgjërshat të shkojnë në flijime  
 Nuk jeni as zota, as shenjtorë.  
 Prandaj nuk gjunjzohem para jush  
 dhe fjala ime veshët ua mbyll  
 e dëgjoni si lutje të një përvuajturi,  
 si kërcënim ose porosi e shqiptoj-  
 zgjidheni vet.

Mos bëni nga unë metaforë  
 që t'i jepni kuptim  
 pa kuptimësive të shumta  
 as parregullsive të lidhëzave  
 që të krijoni rend  
 midis kaosit mendimtar.  
 Mos më vendosni në fillim  
 që tua tërheq gjithë atë peshë  
 ose në mes- midis dy presjeve  
 të hapësirës së vogël e të zbardhur,  
 sepse atje do të më ngulfatni  
 do të më pa shpirtëzoni  
 por, mosni as në fund  
 që pas meje të vendosni pikë  
 dhe me te të më heshtni  
 ose para tre pikave  
 që ndonjë i tretë ta përfundojë.

Mos më thithni kur  
 dëshmitë i keni të etshme për semantika  
 nuk dua të jem vetëm formë.  
 Mos më shtrini, mos më tërhiqni,  
 në dy anë të ndryshme,  
 me një vizë  
 shtyllë midis palcës sime  
 kështu nga unë gjaku i ftohtë derdhet  
 dhe jetë u jep atyre  
 që të palodhshëm shtrihen nën mua  
 -pjellë kurvërie në damarë të vetëdijes.

Nuk dua tu bëhem shpëtimtar.  
 -e pa denjë më është një vdekje e tillë.

Nuk keni brengë për mua?  
 E di!  
 Nuk më krijuat ju?



E di!  
Më krijuan paraardhësit tuaj.

Më lërmëni, më hidhni,  
Më harroni, më braktisni...  
Unë do t'ë vdes, por ato përsëri do të më lindin  
dhe përsëri do të më krijojnë  
nga hiri nën cungje  
me të cilat digjeshin Nënata e mia,  
atëherë kur ju nuk do të ekzistoni  
Më lejoni të jem i vetmuar,  
vetëm fjalë e thjeshtë, dhe shenjë e thjeshtë  
diçka që tregon në diçka tjetër.

## MESHA DERI TE NJË QEN

Ej, ti endacak  
me këmbën e përgjakur  
që shkon pran tabutit  
të paraardhësve të mi  
vrapon para meje  
deri sa unë shkoj pas tyre,  
dhe më shikon me pikëllim  
dhe ndalesh nga mëshira  
që të mos qajë i vetëm.  
Mos u ndal, mos prit...  
Shko!

Shko atje ku  
aroma e freskët e tokës  
pas erës të thërret  
dhe prit te brazda, (hulli, përroska)  
në të cilën shtrihen situatat  
të ngjyrosura me ngjyrë prej pikëllimi.  
Në një moment  
të kohës që shkon,  
vargan njerëzish  
të veshur me të bardha  
do të presësh atje.  
Ata do të mbajnë flamur  
dhe mbi të një mollë  
e prerë do të mbetet.

Piskëllimë do të dëgjosh atëherë,  
 por jo nga qarja  
 por nga zurrat e tyre,  
 të bëra nga druri arës  
 që e kam moshatarë.  
 Ata këngë do të këndojnë  
 dhe valle do të hedhin,  
 ngase një i afërm i tyre,  
 me nënën e vet  
 përsëri do të martohet  
 kurse para tyre,  
 mua do të m' kujtosh,  
 por mos leh dhe  
 -më lejo të fundosem në qetësi,  
 meqë deri atëherë  
 me gjyshin tim  
 për herë të parë do të takohem.

Kur mbrëmja do të vij ,  
 kërko pushim për fuqinë tënde  
 -shtriju atje  
 ku toka është më e butë  
 dhe prit atje  
 të kalojmë disa vera të ftohta.  
 Dhe kur uria  
 me tërbim do të zgjojë  
 të zaptohesh  
 pas hijes tënde.  
 Nën të ti filllo gërmosh  
 -me shputat tua,  
 në djepin e helmuar  
 shpëtimin do ta gjesh.

Deri sat ë mundesh  
 brej gjakatarisht  
 dhe mos u ndal nga dhimbja  
 thithe gjithë atë palcë  
 që do ta ketë shijen e jetës  
 dhe aromën e të shprehurës  
 Përsëri do të kujtohet  
 se si një shpirt endacak  
 në trupin tënd  
 gjen shtëpi të re  
 dhe prej fisit tënd  
 do të mohohesh.

Pastaj mos ri atje  
dhe mos u bërë memec  
shko midis (gjinisë)pjellës së re,  
rikujtoje për prejardhjen  
shënoje një ringjallje të re.  
Me të lehurën tënde  
ndoshta do kafshosh një ndërgjegje  
rastësisht të endur  
nëpër të njëjtat shtigje.

## **AKOMA E PRES**

1

Në jehonën e pjellshmërisë së mallëngjimit  
dy shigjeta të ndryshme  
paturpshëm bëjmë dashuri  
të shtrirë njëra mbi tjetrën  
në dorën time,të kthyer nga veriu

E pres!

Do të vij njeriu  
edhe pse nuk më lajmëroi  
kohën e mbërritjes së tij.

2

Më duket se në pritje kaloi shekulli,  
kurse deri atëherë oborri i kishës  
në të cilën nuk jeni të pagëzuar  
kambanat me piskamë zërohen  
dhe kërkojnë tjetër vend për jehonë.  
I posa linduri vdiq apo I vdekur lindi,  
filloi dita apo gdhiu mesdita-  
Fantazma për fillime të reja.

Akoma e pres!

Po, do të vij njeriu.  
Edhe pse kurrë nuk na paralajmëroi  
kohën e mbërritjes së tij.

3

Deri te kulla e vjetër me çelës të humbur  
zemra e robëruar e përmytur në ëndërr  
dhe nga vetmia pushon së rrahuri  
nga ana tjetër,  
lajmëtarë të pa dërguar nga zoti

në emrin e tij paraqiten  
-me lajmërim të ri për ndonjë fillim të ri.  
Ose është ditë e re, ose dikush  
lejoi të gjykohet dita  
dhe ta pres me një shpatë të padukshme  
që vetëm i frikësuari  
mund ta shikojë.

Dhe po, unë akoma jam këtu!  
E pres atë,  
edhe pse kurrë nuk përmendi  
as vendin e arritjes së tij.

4

Lokomotiva klithi si për herë të fundit  
dhe në klithjen e saj u dëgjua dhimbje-  
hijet e shpresës sime shkuan  
me trenin e fundit të pasdites.  
Nuk më thane lamtumirë  
por e dinin se ku i dërgonin  
-në pushkatim me të shtëna të qeta.  
Që sjellin vdekje të ngadalshme, por të sigurt,  
Si festë për triumf të dhimbshëm  
të fantazmave të ringjallura.

Dhe përsëri mbeta vet  
akoma Atë e pres,  
edhe pse nuk më kushtoj as kokën, as vendin,  
në arritjen e tij triumfale.

\*

O, qofsha i mallkuar!  
A u humba midis kohërash  
të shqyera në pakohë  
apo në vendin profan  
pritja takimin e parë e të shenjtë?

Apo ndoshta...  
ai mu paralajmërua  
vetëm në ëndrrën që kurrë  
nuk e ëndërrova deri në fund.

Akoma e pres...

*Përktheu nga maqedonishtja: Remzi Salihu*



## Mohammed EL AMRAOUI (Marok / Francë)

Mohamed El Amraoui lindi në Fez më 1964 dhe jeton në Lyon, Francë, prej vitit 1989. Është poet, përkthyes dhe aktor, shkruan në frëngjisht dhe arabisht dhe bashkëpunon shpesh me muzikantë dhe artiste. Ftohet shpesh në festivale ndërkombëtare poezie. Ka botuar mjaft libra dhe publikuar CD e libra artistikë, duke përfshirë *De ce côté-ci et alentour*, (Nga kjo anë dhe rrethinat), *L'Idée bleue*, 2006, *Dritarja*, e diel dhe ditët e tjera (në arabisht), *Fadâ'ât*, Amman, 2007, *Récits, partitions et photographies*, (Tregime, partitura dhe fotografi), *La Passe du vent*, 2007, *Accouchement des choses*, (Lindja e gjërave), *Dumerchez*, 2008. Përkthen poezi arabe në frëngjisht dhe ka botuar, mes tjerash, poezi nga Saleh Diab dhe një antologji me poezi bashkëkohore marokane.

"Mohammed El Amraoui shkruan, flet dhe lexon frëngjisht. / Mohammed El Amraoui shkruan, flet dhe lexon arabisht. / Mohammed El Amraoui shpik imazhet e veta dhe strategjitë e veta sintaksikore dhe gramatikore. / Mohammed El Amraoui shmang fjalët konvencionale; ka krijuar një 'zjarr në majën e gjuhës' dhe zbuloi që 'dielli është pak i dobët'." [B. Bretonnière]

### FOTOGRAFI

Matanë qytetit  
arrij në një urë që nuk njoh.

Shkallët në të dy anët shpërthejnë flakë  
dhe palosen prapa kundër mureve të liruara  
sikur të bëheshin pìrg në vend

Në të kaltrën e thellë të mbrëmjes  
mund të dalloj vetëm fillimin e një fjale,  
ndoshta ndjenjë ose ndjeshëm...

Në mes të gjithçkaje bie nata.

Shkallët përhapen si shpatulla  
në secilën anë të një binari të hekurt që shtrihet në atë  
që mund të jetë përgjigjedhënësi telefonik  
në gojën e urës.

Nuk mund të shpërfill kollën time

dhe gjithçka që shpie  
lart nëpër shkallët e brinjëve të mi.  
Dërrasa e hekurt e kraharorit.  
Kalimi mjaft i brishtë për frymë.

Diçka e shkarravitur në qymyr druri:  
një shkarravinë  
nëpër pragun e ndjenjës.

2.

Radha dritaresh e derdhin veten për lumin.  
Nata mbështetet me gjithë peshën e saj mbi mend-  
jen.  
Për të panjohurin është sikur të ecësh me zor nëpër  
ujë.

3.

Në njërën anë  
gjëmimi i lumit hedh hijen e urës.

Në anën tjetër  
hija e një ure i ngjitet murit të vjetër  
që e mban në vend.

Në një anë tjetër  
drita zhytet, shtresë pas shtrese, në shtratin e lumit  
pa u vënë re.

Bronzi dhe bakri i mbrëmjes  
zhytem në gojën time.

Përkthyer në anglisht nga Lavinia Greenlaw, nga an-  
glishtja në shqip nga Silke Liria Blumbach

Pra unë them që dikush po flet, pra unë them që di-  
kush po flet për mua, pra unë them që dikush po flet  
për mua kur unë po flas, dhe brenda meje kjo është  
heshtja të cilën dua të lëshoj, por dalin fjalë duke u  
shkrepëtuar, zbardhëllim, i hutuar

Nata, mbi të gjitha, e papërshkrueshme  
mbulon të gjitha  
këto  
skorie


dhe vjen  
heshtja

pastaj, më vonë  
dhe plluquritjet që pasojnë

Secili prej kërcimeve përmban kërcime më të vogla,  
secili konciz dhe i skalitur si diagram, më i vogël,  
mezi i deshifrueshëm.

Një femër thotë: Nuk i njoh të gjitha lartësitë e kërcimeve të tua, ende nuk i njoh. Dhe nata vjen nëpër dritare; nata i jep dritares mprehjen e syrit të një maceje. Një errësirë i rrethon sytë; rrokje, rrokje pas rrokjeje, feta të holla; që është e tëra që ka mbetur

*Përkthyer në anglisht nga Norbert Bugeja dhe Emilie Jones,  
nga anglishtja në shqip nga Silke Liria Blumbach*







## Ag APOLLONI (KOSOVË)

U lind më 1982 në Kaçanik (Kosovë). Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në vendlindje. Në vitin 2005 diplomon në Degën e Letërsisë Shqipe, në Fakultetin e Filologjisë (Universiteti i Prishtinës).

Në vitin 2006, diplomon në Degën e Dramaturgjisë, në Fakultetin e Arteve (Universiteti i Prishtinës).

Në vitin 2008, mbaron studimet e nivelit

Master për letërsi dhe regjistron studimet e doktoratës; angazhohet mësimdhënës në Departamentin e Gazetarisë.

Në vitin 2009 pranohet asistent i lëndës Letërsia botërore në Degën e Letërsisë së Përgjithshme dhe Krahasimtare. Po ashtu në të njëjtin vit punon, kolumnist i kulturës në gazetën "Koha Ditore", si dhe publikon librin e parë "Zomb", i cili shpërblehet me çmimin kombëtar Libri më i mirë poetik i vitit 2009.

Në vitin 2010 pranohet mësimdhënës i rregullt në Degën e Letërsisë Shqipe dhe në Degën e Letërsisë së Përgjithshme dhe Krahasimtare (Universiteti i Prishtinës); emërohet kryeredaktor i revistës letrare "Jeta e Re", redaktor kulture i gazetës "Lajm", si dhe boton dy libra: Drama (Stefani, Halloween, Judita, Mat) dhe Parabola postmoderne.

Në vitin 2011 monodrama Stefani (Stefan, Die Geschichte eines Augensammlers) botohet në revistën kulturore austriake Lichtungen.

Ka botuar shkrime të ndryshme nëpër revista shkencore e letrare në gjuhë shqipe, gjermane, italiane e boshnjake dhe ka marrë pjesë në disa sesione e seminare shkencore kombëtare e ndërkombëtare.

Është anëtar i PEN Qendrës së Kosovës dhe i Lidhjes së Shkrimtarëve të Kosovës.

## AVENUE

Qielli qan  
Bulevardit rrjedhin lot  
Lisat shkulin flokët nga dhimbja për ne

Ty era t'i derdhë flokët e verdhë  
Fjalët e mia t'i lagin sytë

Ti me flokë të derdhuna derdh lot

Është terr  
Natë shtatë herë e zezë

Ti kokën kah un nuk e kthen  
Gjakun n'ball ma ndezë

Hijet tona shkojnë si siluetë e trupit siamez

Amfitrita e detit t'ndjenjave t'mia  
Ji e sinqertë t'lutna  
Shikomë n'sy

Ti fshan me kokën mënjanë  
Ni mur mes nesh ka hy

Ne ndalemi  
Ti fshin lotët në terr  
Në stacion ni buss urban ndalet  
Ti hyn e disa dalin

Ti shkon  
Kokën mbrapa nuk e kthen  
E un po marr malin

## RETORIKA E HESHTJES

Sa i madh deti e sa të vegjël njerëzit

Lahen edhe mbasi në breg ndizen dritat  
Lahen trupat, s'ka det që i lanë shpirtat

I bie trup ujit me barkë  
Tanë kjo kaltërsi mbi e nën mu'  
E unë mërzitem për dy gogla blu

Të kërkoj si hero i marrë  
Dulqinja eme e dashtun

Emni dhe mungesa jote janë gjithkund  
Barka bart fjalë, uji mban heshtje

Nji ciceron më cicëron në vesh  
E unë hesht si peshk

Dhe heshtja ka gjuhën e saj  
Mendimet dhe ndjenjat në të bëjnë not  
Vij vërdallë mbi ujë e dhé  
Dhe vuej për ty si Don Kishot

Unë shkruj për fate njerëzish  
 Po fatin tem tjetërkush e ka shkru'  
 Ti gjithmonë me ikë prej meje  
 Unë gjithmonë me t'kërku'

Nji ditë si kokrra e kripës në flakë  
 Ka me plasë heshtja  
 Atëherë kam me vdekë nga mërzia  
 Apo nga kureshtja

Me gjuhën e peshkut  
 I drejtohem Zotit:  
 Merre ujin  
 Merre qiellin  
 Merre krejt këtë kaltërsi  
 Se e gjitha t'përket ty  
 E kthemi mu' veç dy sy

Zoti hesht  
 Peshqit heshtin  
 Hesht dhe unë

Si për inat askund nuk dukesh ti

Turistët kalojnë pranë heshtjes  
 Dhe heshtja ishte pranë Perëndisë  
 Dhe heshtja ishte Perëndi

*Ulqin, korrik 2010*

## ZOMB

Ti mâ nuk je  
 Un jam dhe s'jam

Për herë t'mbramë ti m'i njome sytë

Tridhetë e tre lot nga sytë i nxora për ty  
 I futa në fijen e flokut tand të mbetun në nënkresë  
 Rrugës kahdo shkoj i mbaj si tespî  
 Lot e lutje lidhen n'udhëtimin e pashpresë  
 N'venat e mia nuk rrjedh gjak, po lot  
 Un jam pikëpyetja ma e madhe n'botë  
 Asgjâ mâ nuk m'prek n'shpir  
 Kaloj mes të gjallëve si pranë vorreve  
 Shurrën e bâj n'faltoren ma t'afërt

Pshtyj n'vende t'shejta pa drojë  
 Brengat dëshirat epsheet e femrave  
 Mâ nuk i kuptoj

Sa herë shikoj qiellin blu  
 Më kujtohen sytë e tu

Si Diogjen kërkoj shpirtin tem  
 E askund nuk e gjej  
 Lypsat kot shtrijnë dorën kah un  
 Zemra që dikur ka mujt me u prekë  
 Tashma ka vdekë

Un jam Zomb Zomb Zomb  
 I ngujum n'mes dy botëve  
 Zotin dhe omin i njoh i shoh  
 Po kurrigjâ nuk më ngroh

I vetmi shteg për me i ikë dëshpërimit  
 Vdekja âsht

Qielli çahet toka trandet  
 Prej vorreve dalin të vdekurit  
 Du me shku me ta  
 Po për ta jam përtej vdekjes  
 Për të gjallët jam natanë jetës  
 Hijen teme s'e shoh ditë as natë

Du me vdek' po nuk jam gjallë  
 Du me jetu po jam kufomë  
 Mes jetës e vdekjes shkoj vetmitar  
 S'kam miq të gjallë as fantomë

Nuk m'prekin lotët klithjet as gjaku  
 Si vrasës ec në mesnatë  
 Hana sheh kah un  
 Dhambët e ujkut m'i zgjat

Njeriut ia nxjerr sytë e dhimbje nuk ndjej  
 Femnat i kafshoj n'fyt dhe vazhdoj ma tej

Shoh të vdekunit  
 Si krujn dhambët me eshtna t'njomë  
 Mbas darkës së majme  
 Disa zjarmin me drasa arkivolesh e ndezin  
 Dhe vallen e vdekjes të tjerët krahë për krahë e hedhin

Me të gjallët nuk m'rrihet  
Prej të vdekunve askush nuk më njih  
Mes dy botëve i ngujum  
Larg Edenit  
Larg teje  
Ni dolli e ngre

Çohu viktima eme  
Fell në zemrën tande hapma ni vorr  
Mos m'le me u end' rrugëve si kufomë e gjallë





## Ana BAGËRJANA (UKRAINË)

Poete, beletriste, dramaturge, përkthyesë. U lind më 24 mars 1981 në qytetin Fastiv, rrethina e Kievit. Në vitin 2004 magjistroi në Institutin e filologjisë në Universitetin nacional "Taras Shevçenko" të Kievit (specializimi: gjuhë dhe letërsi ukrainase). Ka punuar si gazetare në më shumë medime (televizion, radio, shtyp), Sekretare e Këshillit të Lidhjes Nacionale të Shkrimtarëve të Ukrainës për punë me autorët e rinj, redaktore kryesore e revistës "Granosllovie".

Është anëtare e lidhjes Nacionale të Shkrimtarëve të Ukrainës dhe Asociacionit të shkrimtarëve ukrainas. Autore e librave poetikë "Lule fjalësh"(2000), "Mes ëndrrave violete" (2002), "Mes zotërave dhe neve"(2005), "Shëtitje në litar" (2008), "Linjat tjera" (2009); romanet "Etimologjia e gjakut" (2008), "Sa dashuri mahnitëse" (2010), libri me tregime për fëmijë "Jeta e fëmijëve të dalluar" (2010); vepra dramatike dhe libreto për mjuzikëll "Gloria", si dhe shumë tregime, novella, ese dhe vështrime kritike.

Përkthen nga gjuha polake, bullgare, maqedone, serbe. Për vargjet e saj, dramat, romanet dhe pëprkthimet ka fituar më shumë shpërblime letrare ukrainase dhe ndërkombëtare: "Rukomesllo", "Koronimi i fjalës", "Smoloskip", shpërblimin Ndërkombëtar gjermnao-ukrainas "Oles Gonçar", "Pena e artë" (Bullgari), shpërblimin "Marusja Bek" (Kanada) etj.

Poezitë e saj janë përkthyer në gjuhën polake, azerbajxhanase, bullgare, ruse, maqedone, frenge, angleze, gjuhët latfike.Është pjesëmarrëse në mbremjet poetike të Strugës (2008).

Tani jeton në Shkup, punon si gazetare dhe shkrimtare.

Tani jeton në Shkup, punon si gazetare dhe shkrimtare.

### FILLIMI

Nga fillimi ishin plagët  
e nga plagët rridhte qielli

në qiell u shfaqën nyje limfatike  
që i lidhën bashkërisht  
të gjitha ato strajca të çuditshme

ashtu që në mënyrë kaotike  
u përziën nëpër qiell

(ku u takuan vallë...?)  
e më pas nyjet u rritën  
u bënë të rënda

si gurëz

dhe si gurëz  
u shkapërderdhën tatëpjetë

duke krijuar diçka të ngjashme  
me ato (tanimë të ndërlidhura) strajca  
që secila u emërtua  
me emrin e Zotit

dhe vetë u bënë zotëra  
sepse menduan  
se nuk ekziston më  
askush në qiell  
(thjeshtë harruan plagët  
prej të cilave  
fillonte Kozmosi)

## **PËRAFËRSISHT AJO ËSHTË ATJE...**

Ajo përafërisht është atje  
ku Zotit iu harxhuan penjtë  
ku toka nuk është e qepur me qiellin  
rrotullohet në qark  
si shputë e këputur e arushit të kadifenjtë –  
imtësisirë e fëmijërisë së huaj

ajo është përafërisht atje  
ku dora e Zotit  
nuk prek hijen e drurit të vetmuar  
të prerë nga duart e njeriut  
përkundrejt Festës

ajo përafërisht është ashtu  
sikur dielli të bjerë në gjunjë  
dhe të lutet për falje  
nga ti  
nga unë  
që shumë vonë  
i ka pjekur  
zemrat tona

## **ERA U HESHT**

Ai ma dhuroi pëlhurën –  
era u hesht.  
Ai ma dhuroi barkën –  
deti u tha.  
Vetëm krahë  
nuk guxoi  
të më dhurojë.

*Përktheu nga bullgarishtja – Adem Abdullahu*





## Jan BAEKE (HOLANDË)

Jan Baeke U lind më 23 maj 1956 në Roosendaal. Është poet dhe përkthyes. Punon për Muzeun e filmit në Amsterdam. Si poet, ai bëri debutimin e tij në vitin 1997 me *Nooit paarden zonder de* (Kurrë pa kali), për të cilën poeti holandeze dhe eseisti Erik Menkveld ka shkruar: "Jan Baeke pëlqen të përfshijë lexuesit e tij në situata të çuditshme".

Nëpërmjet zbulimeve të tij poetike, në kërkimin e tij për koherencë, ose të paktën disa rrokje në realitet, Baeke na tregon sa e pasigurt, e shkrifët dhe e paparashikueshme është bota rreth nesh në të vërtetë.

- Libra të botuara:
- *Nooit zonder de paarden* (1997)
- *Zo is de zee* (2001)
- *Iedereen is er* (2004)
- *Groter dan de feiten* (2007)
- *Brommerdagen* (2010)

## ANA E VERËS

Si të rrish përpara vapës?

Djersij, rri i qetë, mendo për detyrën tënde  
t'i mbash mendimet të zbrazëta, ji dritë për shembull  
ose përqafo murmurimën e krijimit

shih Zotin që kalon, rrugës  
për të prerë një pemë  
ose shkruaj qetësisht çdo gjuhë në një bllok.

Një kollonë milingonash marshon nëpër shtegun fushor  
pa theks, pa asnjë mesazh,  
pa fryt ose firmë.

Nëpër të njëjtin shteg fushor, punëtorë toke  
dhe mbijetuesit e një epoke të zezë si katran  
kishin ecur për në fshat.

Qershitë ishin mbledhur, grumbuj druri gjendeshin pranë shtëpive  
sobat mbaheshin në zjarr me shpallje të palexuara.

Kryetari i bashkisë gjendej në derën e barit.  
 “A kishit gjë për të ngrënë?”  
 “Po, boll”, tha i vetmi  
 që ende kishte një gjuhë.

\*

Zëra fëmijësh thërrasin: puthmë, puthmë.  
 Zëra të patymosur.

## E SHPIKA

Mund të vë gjithçka në vende të ndryshme.  
 Ta vendos tryezën atje ku drita nuk e gjen dot.

Kam përgatitur ujë dhe soda  
 do t’ju shërbej shpirtra në shtrat në rast se  
 dëshironi të shëroheni në këtë krevat.

I vura re duart e tua. Të sëmura dukeshin, të përhum-  
 bura  
 kishin bredhur nëpër qytetin, vuajtur kudo.

Gazeta pohon një shërim të suksesshëm.  
 Të gjitha masat, thonë zëdhënësit, ia presin shkurt  
 vetmisë, mungesës së qëllimit të stinëve.

I numëroj cigaret që solle, i pi vetëm  
 ato teke.

Pres reshjen e parë të borës, shpalos frutat e fundit  
 të thahen  
 ua hap derën burrave me zëra të larta.

Ushtarë po hyjnë duke paralajmëruar borën  
 e një zjarri më poshtë në rrugë.  
 Biseda me ta lejon pirjen e duhanit.

Mizat janë bërë të egra  
 nëse s’jam vetëm unë, më shkrove  
 dhe pushë rreshta më të bukur në lajmet.

Është zakon të presësh ca minuta e pastaj  
 ta hapësh derën me zor.

A jam përgjigjur në letër sa nervoz isha?  
 Sapo i kisha vënë fashë dorës sate.  
 Trajta jote u bë gjithnjë e më e dukshme.

Ishe ulur pranë dritares, përshkrove bisedat që

mbushnin mbrëmjen.  
 Jo më e qetë se një sallë pritjeje  
 por më e vdekur ishte bota atëherë  
 dhe të gjitha rrëfimet banonin në mendje të mbyllura.

Mënyra se si pive duhan  
 tradhëtoi pozën tënde duke pritur  
 tradhëtoi zgjedhjen time të ngathët fjalësh.

Në dëborën e parë pashë se si i dogje duart.  
 E kujtova rreshtin "po vjen pranvera"  
 dhe vështrova nëpër supin  
 e pashë atëherë se ç'mbetej prapa.

## HARI THOTË


Hari thotë  
 të gjithë zogjtë janë si ajo.  
 Ai përshkruan krahët  
 e një gruaje të re  
 që është e re  
 por nuk njih një zog.

Hari thotë  
 kështu janë zogjtë.  
 Si era  
 që të sjell joshjen e saj.  
 Si jehona e erës.

Vetëm kur era  
 fryn për herë të dytë  
 thotë Hari.  
 Vetëm kur dashuria.  
 Por ai ka kërkuar në shtëpi.  
 Hari thotë  
 Nuk kam pothuajse asgjë në shtëpi  
 një karrige të vjetër dhe të çara.

Gjithçka për erën  
 thotë Hari  
 ose për vitet e saj  
 që bëjnë që të njëjtat gjëra zhduken.  
 Ai do t'ia japë një zog.

Unë do t'ia jap një zog  
 timin  
 ajo  
 thotë Hari.





## Samira BEGMAN (ZVICER)

Samira Begman Karabeg u lind më 1954 në Husimovc, Sanski Most. U diplomua në tregti financiare dhe menaxhim në Universitetin e Zyrihut, ku jeton prej vitit 1977.

Samira shkruan poezi dhe prozë në gjuhët boshnjake dhe gjermane dhe përkthen në të dy gjuhët. Veprat e saj u përfaqësuan në pesë antologji të botuara në Zvicër dhe në Gjermani. Samira

ka botuar tre libra të mëvetësishëm me poezi në boshnjakisht dhe dy në gjermanisht.

Projekti i saj i tanishëm i përkthimit është përkthimi i poezive të Paul Celan-it në boshnjakisht.

Samira është themeluesja e shtëpisë botuese "Dhira", vizioni i së cilës është "Autorët për autorë". Nëpërmjet shtëpisë botuese ka dhuruar disa qindra librash për një numër bibliotekash komunale dhe shoqatash humanitare që veprojnë në Bosnjë-Hercegovinë.

Samira është anëtare e redaksisë së "MaxiMinus"-it, revistës satirike interneti, dhe ndihmës-kryeredaktore e "Diogen"-it, një revistë kulturore.

Samira Begman është anëtare e Shoqatës së Shkrimtarëve të Zvicrës Lindore.

## ENDËS

Përshëndetje

Kërkuesit tim fundor udhe

Pushtuesit tim suprem.

Isha duke vdekur, qetësisht, butësisht

Dredhova e pastaj rrija zgjuar në errësi,

Jehonë kumbuese

E dëshirave të mia

Dhe tash kjo udhë e re

E panjohur

E ngatërruar me mister dhe ëndërr

Duke i ndarë fijet dhe duke i thurur prapë

Ti më mbështjell

Krahët e tu më urojnë mirëseardhjen

Udhëheqësi im më i dashur

Do të qetësosh dhembjen time.

Jam e etur të mësoj.

Fol!  
 Nga vjen?  
 Për se shërbejnë këto zbukurime?

—————...—————

Për se shërbejnë këto zbukurime? Shkëlqimi!  
 Unë jam ti, kuptove?

Emrin e kam mall  
 Mallin e fillon tani të ndiesh  
 Malli të udhëheq, të bën atë që je  
 Një shenjë e një hije të mundshme.

Unë jam dhembje  
 Që djeg dhe lodh  
 Nëpër zemrën dhe gjoksin tim  
 Kur shpresa kthehet në një grumbull hiri.

Unë jam shkëndija në errësi  
 E ndezur nga të parët  
 Shëroj dhe u jap shpresë  
 Atyre të humbur në zbrazëti.

Jam gjithmonë këtu  
 Për t'i mbushur boshllëqet  
 Për të pastruar dhe për të ndarë  
 Për të shëruar dhe për t'u dorëzuar  
 Për t'i lidhur fundet bashkë.

Si? Pse? Ti pyet.  
 Atëherë dëgjomë!

Nëse një njeri  
 Ka për të qëndruar në rrethin e shenjtë  
 A do të mund të njohë  
 Arsytet e përshpirtshmërisë së tij?

Do të të udhëheq  
 Shiko kufijtë e shpirtit tënd  
 Shiko mirë,  
 Përkul dhe puthe dheun që shkel,  
 Zbraze mendjen, mos e përfill dhembjen  
 Pa frikë dhe pa tendosje.

Depërtoje hijen dhe mëso  
 Nga vjen drita.  
 Besim dhe forca e vullnetit do të të rrëzojnë në  
 injorancë

Falja është hapi i parë në rrugën e diturisë.

Zbrit në ferrin tënd të brendshëm, ballafaqoje fël-  
liqësinë

Të shoqëruar nga shtatë luftëtarë të fuqishëm

Që banojnë brenda teje.

Zgjoji

Liroji

Dhe në çdo luftë do të dalësh fitimtare.

I pari është Dashuri

I dyti është Urtësi

I treti është Vullnet

I katërti është Rend

I pesti është Këmbëngulje

I gjashti është Durim

I shtati është Mirësi.

Unë jam endësi.

Në hapin më të lartë,

Aurën e faljes,

E thur fustanin e nusërisë

Prej arit të çiltër.

Të lidhur me Dashuri,

Të lidhur me pasionin e qenies sime,

Duke pulsuar me zemrën time,

Duke jehuar ëndrrat dhe malltet e mia,

Fijet e arta shkrihen.

Unë jam përcjellësi i fesë

Meqë di se ç' do të ndodhë Nesër,

Meqë kuptoj pse ndodhi Dje,

Meqë shkrij Përvojë dhe Fe

Duke thurur

Duke nderuar

Të Shtatë Simbolet.

Dashuri;

Fillimi i jetës,

Arsyeja e të gjitha arsyeve.

Urtësi;

Përftohet nga Dashuri

Lumi i arit.

Vullnet;  
Nga veprat e Dashurisë  
Dhe Urtësisë.

Rend;  
Fuqi  
Që përsos aktin e krijimit.

Këmbëngulje;  
Stabilitet,  
Që të prij në destinacionin e fundit.

Durim;  
Nënë,  
Që i jep jetë mirësisë.

Mirësi;  
“Simboli i të gjitha simboleve”  
Maja e piramidës,  
Mbretëria e faljes,  
Një fustan nusërie  
I thurur me dorë,  
Me të qepur ari.

## **E VETME, SHUMË LARG NJËBRIRËSHIT**

Përpiqem sa mundem të shoh pasqyrimin e tij në të  
tjerë  
Kështu e shkëpus dhe holloj natën,  
Dua të jem në ëndrrën e tyre, në loçkën e tyre të  
syrin  
Në bërthamën e identitetit, matanë shprehjes  
Gdhende fjalën, Fjalën, e cila  
Do të pëlçasë nën barrën e trashëgimisë  
Në një shatërvan zanorësh, kështu që urtësia  
E fshehur, në çastin e shenjtë të krijimit të  
Fillimit, do të shpërbëjë në njëmijë pjesëza  
Errësisë e përhershme, atë fjalë rreth nesh.

Prej kohës kur, si pluhur yjesh  
Unë dhe Njëbrirëshi u bëmë njësh  
Hasem me njerëz që  
Duken njëri ashtu si tjetri  
Dhe tiparet, karakteristikat e të cilëve  
Gjenden veçmas nga më shumë se një qenie  
E vetmja qenie që dhemb dhe  
I është përkushtuar rrënimin të thelbit të vet




Jam në ankth, e ndiej rrëqethjen  
Kur shoh se çfarë ka mbetur nga  
Mbeturina e natyrës së tyre të vërtetë, dhe ç'mbeti  
Për të qëndruar në shpirtrat e tyre nuk është gjë  
përveç  
Një valle e shpejtë hijesh vdekjeprurëse.

Tepër vonë

I shtrova Atij  
Mijëra pyetjesh,  
"Fëmija ime e dashur, guriçkat e arta  
Burojnë nga goja jote",

Kështu tha ai,  
"Shiko, këtu janë përgjigjet..."  
Shikova  
E shikova...  
Kishte vetëm ujë...

E di tani  
Duhet të isha zhytur.





## Richard BERENGARTEN (BRITANI E MADHE)

Richard Berengarten (dikur Richard Burns, u lind në Londër më 1943) është poet prirës anglez dhe evropian. Ka botuar mbi 30 libra dhe ka marrë mbi një dyzinë çmimesh dhe nderimesh letrare dhe akademike. Sivjet, pesë vëllime nga Selected Writing (Shkrime të përzgjedhura) u botuan në formë libri xhepi nga Shearsman Book. Librat e tij përfshijnë:

Against Perfection (Kundër përsosmërisë), The Manager (Menaxheri), Book With No Back Cover (Libër pa kopertinë të pasme), For the Living: Selected Longer Poems (Për të gjallët: Poezi të gjata të përzgjedhura), In a Time of Drought (Në kohë thatësie), The Blue Butterfly (Flutura e kaltër), Under Balkan Light (Nën dritën e Ballkanit) dhe seria e papërfunduar Manual (Doracak). Projektet e tij aktuale përfshijnë Two to the Power of Six (Dy me fuqinë e gjashtëve), një poezi e gjatë sa një libër e bazuar në klasikun kinez I Xhing.

Richard Berengarten ka themeluar Festivalin e Poezisë të Cambridge-s të bërë legjendar (1975-1985). Mementalisht ligjëron në Universitetin e Cambridge-s. Critical Companion to Richard Berengarten (Shoqëruesi kritik për Richard Berengarten) (2011) përmban 34 ese nga kontribuues në 11 vende.

## KUR AJO KËNDONTE NË BULEVARDIN E BARDHË

Kur ajo këndonte  
në bulevardin e bardhë pranë  
tregut të frutave të mbuluar

bërësit e djathit  
dhe bërësit e kosit psherëtinë  
në këmishët e tyre të mëdha

një lypës pa këmbë, i struktur  
mbi karton në kolonadën e tij  
mbaroi së kafshuari buzët e tij

për pesë sekonda të gjata  
kasapi në qoshe mbajti  
sakicën e tij në mes të goditjes

iridat e një kuqoje kaçurrele  
 nga bojëkafja e tyre e zakonshme:  
 ar i djegur në të gjelbrën e vijëzuar

dhe gruaja që shet  
 luleshtrydhe qeshi  
 duke kujtuar diçka

*Nga Two to the Power of Six (Fuqia e gjashtëve) (26)*

## NUMËRIM

Era vazhdon të numërojë  
 kokrriza rëre mbi duna lëvizëse.  
 Nuk mund të më numërojë.

Vera vazhdon të numërojë  
 yjet në qiejt e tyre të natës.  
 Nuk mund të më numërojë.

Shtrengata vazhdon të numërojë  
 rruzullat e shiut në zemrën e saj.  
 Nuk mund të më numërojë.

Drita vazhdon të numërojë  
 gjëra. Nuk do të mburojë kurrë.  
 Nuk mund të më numërojë.

Vdekja vazhdon të numërojë  
 hordhi harabelash dhe gargullash,  
 flokët mbi kokën tënde dhe

eshtra të zhveshura nëpër grumbujt. Por unë po  
 fshihem prapa gishtave të mi të mbyllur.  
 Nuk mund të më numërojë.

*Nga Two to the Power of Six (Fuqia e gjashtëve) (26)*

## VOLTA

...tani kur po bie muzgu...

Diell mbretëror, i përskuqur, një monedhë e mrekul-  
 lueshme e ditës,  
 kur më prek, lëkura ime bëhet kornë,

shpina ime nerv optik, e trupi drithërohet  
i hutuar nga vrushkujt e artë me të cilat  
e spërkat detin dhe qytetin, jam verbuar.  
Vallë, s'paska pasur këtu – mbase ka pasur –  
vargje shtëpish dhe rrugësh, prona të një qyteti  
tjetër,  
e jo të këtij që ti e ndryshove me rrënjë?

Shëtisim breg liqenit. Barkat e vogla  
të peshkatarëve të natës janë gati të lundrojnë,  
motorët gumëzhijnë, llambat parafine ndriçojnë  
mbi kulmar, qyteti i tërë ka dalë shëtitje –  
të dashuruarit dorë për dore, të rinjtë,  
etërit dhe nënat, fëmijët lëprijnë akullore,  
të moshuarit vështrojnë nga kafe-baret e trotu-  
areve,  
e kodrat pa dritë afrohen gjithnjë e më afër,  
sikur të ishin bisha të zbutura.

Një përskuqje e ëmbël qiellore, e shpërndarë mbi  
kodra e brigje,  
dora jote ledhaton timen, si pa dashje,  
si prekja e gruas së re që kalon pranë meje,  
me vithe të kolme, hapa të imët e ecje gracioze,  
me leshrat hedhur prapa, gushën skofiare dhe  
supat  
bronze vere, e sytë e qeshur bojë kafe ulliri.  
Të pi ty, o shkëlqim drithërues, si të ishe verë,  
muzikë,  
siç të pinin të parët me shekuj.  
Qytet vezullor, emri i saj është Elefteria,  
pra, edhe pse vrragët e tua janë njolla të murrme  
në sytë e saj,  
përsëri, në këtë çast kur shkëlqimi dhe shpërndarja  
e tij  
vallëzojnë lehtas mbi fytyrën e saj, si të ishin fjalë e  
këngë,  
asaj i takon e drejta e motit, të shëtisë nëpër këtë  
port  
si të ishte vegël dhe roje e shkëlqimit tënd  
e cila zhytet në pusët e thellë të bebëzave tua,  
kurse, liria e saj e dashur, kërcen si valltare.

O muzgu i dashur, dritë mijëvjeçare,  
këngëtari me të njëjtin zë, i veçantë posi kjo vashë,  
si të mos mahnitem me mëshirën që i fal

këtij qyteti dhe njerëzve të tij, skulptor  
i cili formëson çdo gjë që prek, botën mbarë?  
U shndërrova në robin e tij, kur nuk jam më banori  
yt.  
Dhe, duke u përmallur të të pi me fund,  
po e vadis çdo pore të rrezes tënde, të lirisë tënde.

*Përktheu Resul Shabani*

***Nga Black Light: poems in memory of George Seferis (Dritë  
e zezë; poezi në kujtim të George Seferis-it)***

27 korrik 2011

## Ç'THA ORAKULLI I DELFIT

Spiuoj me flutura. Përdor thuprën magjike me  
bleta  
dhe kam filtruar kujtesën e ujit  
të mos humbet asnjë pikëz në det.

Lundroj katastrofa dhe kalëroj furtuna të largëta  
të gjurmoj lidhjet dhe format paradoksale  
të druajtura në mesataret dhe normat.

Sytë e mi të brendshëm lexojnë shpirtra. Duart e  
mia shpirtërore  
prekin funde detesh dhe shfletojnë vende të largëta  
për të llogaritur pjesëzat e tyre rëre.

Mbështjell uragane të çelur në poçe të vulosura me  
dyll  
dhe mbështetem mbi Kronos-in dhe avatarët e tij  
t'i lexojë unazat dhe numrit e yjeve.

Gërmoj dialekte të ikura ashti.  
I njoh mendimet e harruara të hedhura nga njerëz -  
që mendonin që askush nuk dëgjon - në shkëmb  
dhe gurë.

Vdekja jote është dritare e zbrazët nëpër të cilën  
kam shikuar.  
Dola jashtë dhe vëzhgova pamjen e gjatë dhe të  
errët  
si të ishte një bulevard në mbrëmje.

***Nga Two to the Power of Six (Fuqia e gjashtëve) (26)***



## Silke Liria BLUMBACH (GJERMANI)

U lind më 13 dhjetor 1970 në Göttingen, Gjermani.

Mëson të lexojë në moshën katërvjeçare. Boton poezi që në adoleshencë në gazetën e shkollës dhe në një antologji. Studime interpretimi/përkthimi në Universitetin e Heidelbergut: frëngjisht, portugalisht, anglisht. Mëson shqip mënyrë

autodidakte. Shkruan tregime, që botohen në antologji të ndryshme. Anëtare e shoqatës letrare "LitOff" të Heidelbergut.

Ajo në dhjetor 2002 emigron në Prizren, Kosovë, dhe në janar 2004 vendoset në Sarandë, Shqipëri. Kthehet në Heidelberg në nëntor 2006. Prej vitit 2010, jeton dhe punon si përkthyesë në kryeqytetin gjerman Berlin, ku është aktive në organizimin e programit të kafenesë letrare "Café Galerie Poesie" me recitime dhe punëtori për shkrim poezie.

Libra të botuara me poezi janë: Dyzet vdekje në Sarandë, Tiranë, 1999, Karavela e fundosur, Tetovë, 2002, Lumi që rrjedh drejt burimit, Tetovë, 2007, Libri i botuar me prozë: Ditari i një kthimi, Tiranë 2010. Ajo u nderua me çmimet letrare "Qiriri i Naimit", në Festivalin Ndërkombëtar të Poezisë "Ditët e Naimit", Tetovë, 2005, Çmimin e krijimtarisë "Naji Naaman", Liban. Kohët e fundit ka shkruar poezi në gjuhën angleze dhe ka marrë një ofertë për botimin e një libri në SHBA.

Poezi e saj u përkthye në gjuhën rumune, boshnjake, kineze, japoneze dhe në gjuhën indiane "odia".

## DASHNORË - FANTAZMA

dashnorë-fantazma  
jemi ne

dashurojmë njëri-tjetrin  
për në jetë

atje ku jam, nuk jam  
atje ku je, nuk je

zemrat fillojnë të rrahin  
në një lëkurë të padukshme

## DUKË NOTUAR NËPËR OQEANIN PAQËSOR

duke notuar nëpër  
oqeanin që duket i pafund

përgjatë shtegut të  
ëndrrave të mbytura dhe krahëve që dhembin

duke gëlltitur vetëm ujëra të kripura  
të padallueshme nga rrjedhat e syve të mi

po mbahem në not  
me një unazë të drunjtë shpëtimi

të bërë nga trupi i Perëndive  
përreth bërthamës së fshehtë të Jetës

nuk do të bëhem  
një pjesë e oqeanit

i panjohur ku u nisa  
duket të jetë një tjetër breg

në dritë vezulluese

mund ta shoh Dritën

## SHKUPI

ajri  
mori zjarr

që në stratosferë  
temperatura ishte pozitive  
për të parën herë  
ngjyrimë të kuqe pastele shkëlqenin  
në qiell si bishta kometash

poshtë në sallë  
flaka u hodhën në ekzistencë

në po atë qytet  
të tundur nga tërmeti  
derisa hyri në dhe  
dhe gjithçka e thyer u rindërtua  
në shëmti më të përsosur

një flakadan u shpërthye nga hiçi  
në kryqëzimin e dy palëve sysh





## Charles FLORES (MALTA)

U lind në Kalkara më 1948. Është poet, shkrimtar, gazetar shkrimi, radioje dhe televizioni. U arsimua në kolegjin "St. Albert the Great", në kolegjin "De la Salle" dhe në Universitetin e Maltës. Formimin profesional e mori në Institutin e Gazetarisë së Beogradit (1977) dhe shkollën "Newhouse" të Komunikimit në Universitetin e Syracuse-s, Nju Jork (1983).

Pas një karriere në gazeta dhe një periudhe të shkurtër pune në Repartin e Informacionit, Flores hyri në menaxhimin e radios dhe televizionit, duke marrë përsipër udhëheqjen e reparteve të ndryshme kombëtare, duke përfshirë programet e lajmeve, radios dhe televizionit, publikimit dhe shitjet, çështjet e grupit dhe arkivat.

Ai është autor i shumë librave letrare dhe gazetareske në gjuhët malteze dhe angleze. Flores është edhe korrespondenti i disa gazetave dhe revistave ndërkombëtare. Poezia e tij në gjuhët malteze dhe angleze u paraqit në edicione arabe, italiane dhe serbokroate. Më 1996 fitoi konkursin për tregime të shkurtra "Commonwealth Short Story Competition" për rajonin Evropë/Kanada. Është i martuar me Margaret dhe kanë dy vajza, Rona dhe Davida.

## FESTË

Dje shkova në një festë  
Dhe hëngra qiejt e bukur të kaltër  
Një diell të artë  
Dhe disa mure çaklli  
Para se ta shuaja etjen  
Me një pije apo dy  
të Mesdheut me akull.

Sheshi i nxehtë  
Dhe dëfrimet gufuese  
Ishin të mirë,  
Por para së gjithash, pranë meje  
Ishte një zonjë e hareshme malteze.  
Kishte shije aq të mirë,  
Sa delikate dhe e dëlirë ishte!  
Sa e bukur, sa e lezetshme!

Mikpritësi im i dashur bënte çmos  
Të na kënaqte të gjithë  
Dhe pjata me plazhe si krem

Dhe bikini të mbushura me akulllore  
 Vërtet na kënaqën.  
 Ajo që e prishi festën në fund,  
 Që na neveriste gjithë skenën,  
 Ishte një gjë zioshe  
 Të shërbyer në pjata vigane  
 Për ta mbaruar festën:  
 Një pjatë plot me ndotje.

**Nga: CORRESPONDENCES (Korrespondenca) (Cog Press, Leicester, Angli, 1973)**

## DËRRASË TRAMPOLINI

Asgjë nuk zë vendin e rinisë...  
 Një lule që rrudhoset poshtë  
     Bam-it zemërgur të kohës.  
 Jam çuni i mirë - la la la la  
     Nga Dylan, Donovan.  
 Ka një këngë që më kujton  
 Ditët tona dhe përqaftimin e humbur,  
 Kohën që kaluam në lumturinë  
 E dashurisë që ndamë.

DHE

Kjo

Më bën të fërgëlloj  
 Duke hyrë në burrëri.  
 Asgjë nuk zë vendin e rinisë.  
 Ja një kamë,  
 Ja një thikë.  
 Prite lulen.  
     Prite jetën time.

**Nga: A VOICE FROM KALKARA (Një zë nga Kalkara) (New Broom Press, Leicester, Angli, 1974)**

## DRU I SJELLË NGA DETI

Si dru i sjellë nga deti, në pjesë të dhembshme, për  
 ibret  
 Pluskojnë, të hutuar, në këto brigje.  
     Të lodhur dhe të etur,  
     Sytë e tyre të përgjakur - një pasqyrë  
     Dëshpërimi.

Si dru i sjellë nga deti në plazhin me rërë  
 Rinë të shtrirë  
 Duke pritur dorën e butë që i ngre  
 Nga mjerimi i tyre  
 Pa pyetur pse.

Si dru i sjellë nga deti, të humbur dhe të gjetur,  
 Të papërdorur dhe të shfrytëzuar,  
 Një burim mrekullie të pakohë,  
 Shprese dhe dashurie,  
 Jetësh më të mira  
 Dhe të ardhmesh  
 ...ja ku po vijmë refugjatët me varka.

**Nga: THE INTERNATIONALWHO'S WHO IN POETRY (The International Library of Poetry, USA, 2004)**

## KOSOVA

Ku po shikoj, ç'po besoj?

- Fytyrat e patrajta?
- Djemtë e humbur prej kohe?
- Pleqtë e plagosur?

Ku të shkoj?

- Të hap më shumë varre?
- Të zë më shumë shpirta?
- Të ngre flamurin e bardhë?

Pse po

- Ndiej agoninë e tyre
- Brengat dhe varfërinë e tyre
- Në shpirtin tim të fshehur?

Ku është

- E vërteta
- Prapa gjithë këtij absurditeti
- Të jetuar nga njerëzimi?





## Shaip EMËRLLAHU (MAQEDONI)

U lind më 13 prill 1962 në Trebosh, Tetovë. Fakultetin Filologjik, Degën Gjuhë dhe Letërsi Shqipe e mbaroi në Universitetin e Prishtinës. Magjistroi në letërsi në Universitetin e Tiranës, në temën "Struktura e poezisë së Azem Shkrelit". Ndjek studimet për doktoraturë. Është mësimdhënës në Universitetin Shtetëror të Tetovës.

Botoi vëllimet me poezi "Pagëzimi i viteve", 1994, "Projekti i thyer", 1997, "Vdekja e paktë", 2001. Më vitin 2001, "Akademia Orient - Oksi-dent" në Bukuresht ia botoi në gjuhën shqipe dhe rumune vëllimin me poezi "Vdekja e paktë / Putina moarte" (Përktheu L. Topçiu). Në vitin 2004, PEN-i kroat dhe Shoqata e Shkrimtarëve Kroatë ia botojnë vëllimin dygjuhësh kroatisht/shqip me titull "Poezi" (Përktheu M. Vikers). Në vitin 2004, Sh.B "Feniks" nga Shkupi ia botoi në gjuhën maqedonase librin me poezi të zgjedhura "Dvorski son" (Përktheu A. Selmani). Në vitin 2000, në bashk-autorësi botoi librin me dëshmi të masakrave në Kosovë "...edhe ne dëshmojmë/We Witness", Sh.b. "Ditët e Naimit" (shqip-anglisht). Shtëpia botuese italiane "La stanca del poeta - 57" në vitin 2009, ia botoi vëllimin me poezi "Stracci di vita", (nga anglishtja përktheu G. Napolitano), ndërkaq, po atë vit i botohet në gjuhën angleze libri poetik "Life's Rags" (Përktheu E.Zaimi/C.Czury). Cikle poetike të tij janë botuar edhe në gjuhën frënge, angleze, hebraike, spanjolle, arabe, rumune, turke, polake, çeke, kroate, maqedonase etj. Poezia e tij është përfshirë në disa antologji ndërkombëtare. Ka marrë pjesë në festivale poetike ndërkombëtare dhe ata vendore. Është nderuar me disa çmime letrare. Ka punuar gazetar në mediet elektronike dhe të shkruara, brenda dhe jashtë vendit. Për disa vite ka punuar redaktor i Rubrikës së kulturës në të përditshmen "Flaka".

Është themelues dhe drejtor i Festivalit Ndërkombëtar të Poezisë 'Ditët e Naimit'.

## TROJA E KALIT

me thikat kafshuar  
zgjerohet gjeografia e trokut

të kalit të Trojës

pëlçet

e s'ta kap ajo e vockla mendje

si e hamë karemin

kur hijet na e veshin trupin

pashë e më pashë me Trojën e kalit

e na bëhet me e bardhë se bora  
shkuma e gojës  
tavolinat na i mbushë

askush s'ia turbullon rehatisë

ç'na mbet nga Troja  
përveç kalit  
me hingëllimën e hiles

**13 janar 2011**

## **NATA E PISTË**

kishin ardhur hijet  
me dritën e hënës  
drita i kishte gënijer  
veshur  
me errësirën e pistë të natës

jetëorgjie kishte çelur  
koha e natës së pistë ish  
deri sa zjarri nuk u ndez  
jetën  
hija e kishte përmbys

## **MOLLËT E TETOVËS**

nëpër koncerte shekujsh  
i krasiste e ujiste Tetova  
Mollët e veta

si kokë kripe  
të vjen të pëlçasësh  
kur i sheh tutje  
si i grin dhëmbi i keq

fundja  
hëngrën aq  
sa t'u mpihen dhëmbët

**Tetovë, 1989**



## Sabahudin HAXHIALIÇ (BOSNJË DHE HERCEGOVINË)

U lind më 23.9.1960 në Mostar, Bosnjë dhe Hercegovinë. Ai është anëtar i Shoqatës së Shkrimtarëve të Bosnjë dhe Hercegovinës (Sarajevë), Shoqatës së Shkrimtarëve Kroatë në Bosnjë-Hercegovinë (Mostar) dhe Shoqatës së Shkrimtarëve të Serbisë (Beograd, Serbi), Akademisë "Ivo Andrić" (Beograd, Serbi) dhe Shoqatës së Gazetarëve të Bosnjës-Hercegovinës dhe Ambasadori i "Poetas

del Mundo" në Bosnjë dhe Hercegovinë.

Është kryeredaktori i revistës elektronike dhe të botuar kulturore "DIOGEN": <http://diogen.weebly.com> dhe kryeredaktori i revistës elektronike "MaxMinus": <http://maxminus.weebly.com> nga Sarajeva, Bosnjë-Hercegovinë.

Ka statusin e një autori të pavarur në kantonin e Sarajevës. Shkruan poezi dhe prozë, duke redaktuar dhe recensuar libra të autorëve të tjerë. Është redaktor i pavarur në shtëpinë botuese "Dhira", Küssnacht, Zvicër. Ka botuar poezi, artikuj, ese dhe tregime të shkurtra në pothuaj të gjitha gazetatat kryesore në Bosnjë-Hercegovinë, Serbi, Kroaci, Slloveni, Maqedoni dhe Kosovë. Poezitë dhe tregimet e tij të shkurtra u botuan në gazeta në Angli, Irlandë dhe SHBA. Poezia dhe proza e tij u përkthyen në anglisht, frëngjisht, gjermanisht, spanjisht, italisht dhe shqip. Ishte pronari i gazetës së parë private në RS, Bosnjë-Hercegovinë, "POTEZ", Bugojno, 1990. Deri tani ka botuar dhjetë libra me poezi dhe prozë. Ka botuar një libër me poezi në Francë më 1998. Vepra e tij artistike është përfshirë në antologji poezie në Francë, Kanada dhe Bosnjë-Hercegovinë, si dhe në Antologjinë e Satirës të Bosnjë-Hercegovinës dhe Ballkanit. Ka botuar disa çmime, mes të cilave më të mirat janë: "May Pen" për poetin më të mirë të ish-Jugosllavisë më 1987 (Svetozarevo) dhe Çmimi i Akademisë "Ivo Andrić" (Beograd) më 2011. Jeton në Sarajevë, Bosnjë-Hercegovinë. Faqja zyrtare interneti:<http://sabahadzi.weebly.com>

## MARGARITAS ANTE PORTAS

Unë jam  
pajtimi  
i ëndrrave të saj

...

Por shpirti i saj  
digjet për paqe.

...

Vendi ku ende nuk ke arritur  
është vendi ku zgjaten shpresat e tua.

...

Shpresa vdes e fundit

....

Me pak fat!

## URTËSI

Vrapoj drejt

Daljes

së vetes sime narcistike.

Pothuajse i sëmurë.

Vrapoj drejt

Hyrjes

së vdekjes sime.

dhe...

po

mbetem i heshtur gjithë rrugës

## LEHTËSIA E PAHARRUESHME E SHPRESËS

A s'mund të kuptojnë

që ngacmimi është duke ardhur?

Nuk kuptojë që realiteti është i ashpër.

A s'mund të kuptojnë

që

në fund të fundit do të vdesin.

...

Po të mos

vazhdojmë të mbushemi

prapë e prapë.


Prej vitit 1990 përpiqemi

dhe dështojmë.

Kemi bërë rrëmuje

prapë e prapë.





## Lulëzim HAZIRI (MAQEDONI)

U lind më tetor 1962, në Reçan të Gos-tivarit.

Përmbledhjen e parë poetike "Kënga lind në vetmi" e botoi në vitin 1989, në SHB "Rilindja" në Prishtinë. Biografia e tij poetike shënon edhe dy libra të tjerë poetik: "Kur dyert hapen me zile" (1995), SHB "Vatra", Shkup, dhe "Dalja nga safari" (2005), SHB "Brezi9", Tetovë.

Përveç se poezi ka botuar edhe tregime ndërsa në vitin 2000 shtëpia botuese "Shkupi" ia botoi librin me shkrime për muzikën rock "Rokenrolli shqiptar!". Në vitin 2010, në botim të SHB "Nositi SH" nga Gostivari botoi edhe librin me kolumna gazetareske "Bardhë e zi".

Është gazetar dhe aktivist për të drejtat e njeriut.

## HOMAZH PËR BABANË

Sa herë që më sillesh ndër mend  
Kur nëpër shtëpi më ndjek  
Shikimi yt i thellë përtej syzeve  
Mungesën tënde e shoh në sytë e nënës

Kur Nata e Premte hap dritaret  
Për shpirtin tënd të lehtë si prekja  
Të lexoj një Ja-Sin në shqipe  
Në ballkon xhaxhai të lexon arabisht  
Me zërin e tij plot patetikë

Si shpesh ha veten  
Pse një herë s`ma the një fjalë të rëndë  
Një shuplakë kur isha fëmijë  
Që e kisha hak në çdo hap  
Unë s`desha të kisha fatin tënd  
As të shihja me dioptrinë e syzeve tua  
Që i ruaj si një dënim i ëmbël  
Të më ndjekin nëpër shtëpi

Kur të kërkoj Ty  
Mbyllem në dhomën tënde  
Ku e shtypje kohën si bishtin e cigares  
Shoh ndryshkun dhe pluhurin  
Që me gjuhë lëpin çdo gjurmë të gishtërinjve të tu  
Me një frymë pastroj çdo gjë  
Librat

Plan-programin mësimor  
Aktgjykimet  
Për një çast shoh me dioptri  
E dora s` më shkon të shkruaj  
Bëj rrathë në qiell e në tokë  
Muzikën e gishtërinjve e dëgjoj

Kur më vjen gjumi në pasqyrat e krevatit  
Lutem ndër dhëmbë për Ty  
Së paku me t`pa në ëndërr  
Nën trungun e qershisë në oborr  
Duke bërë plane për shtëpinë  
Për çdo mëngjes zgjohem esëll  
Me ndjenjën e fajit nën jastëk  
Ëndrrën s`kam kujt t`ia rrëfej  
Pa larë sytë e harroj

Borxh shumë të mbeta  
Për mua bëre shumë  
Sa ishe gjallë  
Të të dhuroja së paku një nip  
Që do ta ulje në prehër  
T`ia tregojë tapitë  
Që unë s`doja t`i shihja me sy

Pse s`u pajtova një herë me planet e shtëpisë  
E pse për Ty mbeta vetëm fëmijë  
Që m`i puthje sytë kur merrja udhë(t)

## NJË GJETH ÇAJI MBAJ NË GOJË

vjen nga vise të largëta ekzotike  
i zi në sandëk druri  
made in Bota e tretë  
si skllav i mbërthyer që pret blerësin  
në kolonitë e reja të zbuluara moti

të blejmë në kuti teneqeje  
dhe nuk çajmë kokën si u vole  
a rritesh në dru si mollë  
apo prej tokës mbin si bimë  
s`merakosemi si ikin vjelësit  
kur vdekja i ndjek si agjent  
për ne ti thjesht rritesh në kuti

të këmbëjmë me dy metra sintetike  
me një sandëk plumba dhe dy pushkë

që rojë e plantazhit t'ï ruajë vjelësit brenda telit  
dhe gjumin e padronit nën palmë

vjen të na bashkosh në ora pesë  
(apo shtatëmbëdhjetë si i thonë në TV)  
mblidhemi rreth çajnikut  
që më mirë se bulkthi këngës ia thotë  
shëtit nëpër dhëmbët tanë të vënë  
tok me fjalët që i hëngri krimbi  
gjuhën na e trash dy gishta  
sa as të fërshëllejme mundemi  
melodinë e këngës fituese  
“Një gjeth çaji mbaj në gojë”  
që është hit në radio

kutitë e bukura të çajit  
i bëjmë koleksion  
madje i ngremë në pop-art  
atje larg fëmijëve të vjelësve  
po u rranë në dorë  
i ruajnë si kuti muzikore

## AJO MË USHQEN

Në mbrëmje si syri yt me bisht  
Gjumi i pendesës kur m`i lidh sytë  
Derës nuk ia vë drynin e ftohtë  
Shpresën lë galuc në prag  
Se sot mos vjen Ti në mëngjes  
Më sjell gazeta cigare e byrek  
Si dje  
M`i sjell sytë e lëngshëm  
Që më bëhet se në epsh notojnë

Në dhomën e verdhë kaotike kur të hysh  
Librat  
Teshat  
Tavllat përplot bishta cigaresh  
Presin duart e tua  
Këngët e dashurisë flenë mbi tavolinë  
Një cikël i tërë  
Shkruar për Ty natë më parë  
Të hysh si skile pa trokitur  
Se mos ma ndërpret ëndrrën dadaiste  
Radion ta lëshosh me zë të ulët  
Tingujt melankolikë të kabasë së mëngjesit  
Të notojnë lehtë si tym

Edhe më lehtë të hysh nën jorgan  
Të ngjitesh për trupin tim  
Si magnet  
Ligjin e fizikës ta kujtosh  
Trupat me pole të kundërta bashkohen  
E të mos humbim kohë kush ç`pol ka  
Ke trup të zjarrtë  
Kam zjarr për dashuri  
Kjo mjaffon  
Si dje

Ti në mëngjes do të vish  
Dhomës që bie erë duhani  
T`i dhurosh pak aromë të parfumit tënd  
Të qeshen muret e mërdhirë nga heshtja  
Zemrën të ma çelësh si kutinë muzikore  
E unë të qeshem si cinik  
Me tinguj të sinqertë  
Si dje



## **Delvina KËRLUKU (MAQEDONI)**

U lind më 1983, në Dibër. Ka studiuar ekonomi, ku ka marrë dhe titullin Magjistër për menaxhimin e resurseve njerëzore, në Universitetin "Kiril dhe Metodi" ISSPI, Shkup. Ligjëron në Universitetin Shtetëror të Tetovës, Shkup. Ka marrë pjesë në Konferenca Ndërkombëtare, Bullgari

në kuadër të profesionit. E drejton shoqatën për art "Josif Bageri". Shkrimet e saj janë botuar në një mori revistash për art, kulturë dhe shkencë, brenda dhe jashtë vendit.

Vëllimet e saj me poezi janë: "Muza", "Altar" dhe "Gjurmë". Është anëtare e Art Klubit në Dibër. Këtë vit në Korçë iu dha çmimi: "Çmimi Special", për krijimtarinë letrare për nivel të lartë artistik, duke sjellë vlera të spikatura dhe të qëndrueshme në fushën e poezisë.

Ka marrë pjesë në aktivitete të ndryshme letrare.

## **LODHJE**

Lodhje me fjalët e botës  
Me rregulla e fjalime,  
Lodhje në mëngjeset, mbrëmjet  
E zhegun e ditëve,  
Lodhje rrugëve plot llahtari pa fund  
Lodhje në pritje dhe netëve pa gjumë  
Lodhje nga malli i grirë dhe i tretur  
Në vetmi e mbetur  
Lodhje me ty dhe vetveten  
A thua kur do të pushoj?

## **NË LUFTË ME VETEN**

Veten e grij  
e ha  
e sos  
Përsëri gjallë,  
Rritem e rritem.

Në luftë me veten:  
Veten e grij  
e ha  
e sos

Derisa të çarat  
 si rrjedhat e gjakderdhjes  
 më shtrijnë përdhe,  
 sfilitem, mekem

## BISEDË ME VETEN

Të bisedoj thashë  
 njëherë me veten time  
 Hë! Ç' do që më shqetëson?  
 Mos do lulet në kopsht?  
 Mos do bjeshkën me pyje?  
 Apo diellin të ngroh tokën  
 fëmijën ku thith  
 qumështin e nënës Loke  
 a rininë kur shkoje  
 në shkollë?  
 Fol pra, pse u nemite  
 çfarëdo  
 që s' u përgjigje  
 thua pak të kam thënë  
 nëpër mote  
 fol pra, pse u shqote!?  
 Prit atëherë  
 pak të kujtohem  
 po, më duket se e qëllova  
 ti do njeriun të qeshet  
 do popullin të gëzohet  
 Ah, vërtet ti do popull  
 në jetë të jetëve  
 të jetoj i lirë  
 në çdo kënd e shtëpi  
 Po a s' është kështu  
 Ti si thua  
 në vetëpohim  
 ti më do e unë të dua  
 Prej asaj dite në këtë jetë  
 unë me ty e ti me mua  
 një jetë të tërë  
 për ta kaluar.



## Nevena KOKANIVOĆ (SERBI)

U lind në vitin 1960 në Lloznicë.

Një kohë ka jetuar në Francë, ku ka punuar si kreatore mode e prodhimeve të lëkurës.

Tani jeton dhe punon në Lloznicë.

Shkruan që nga viti 1974, dhe është autore e këtyre librave: "Djurdjevski selen" (Studio Ras – Beograd, 2000) dhe "Vrelo žeravije" (Apostrof – Beograd, 2002 ).

Poezitë e saj janë të botuara nëpër revista letrera, shkencore dhe kulturore. Është pjesëmarrëse në shumë takime letrare.

Është anëtare e Unionit të Shkrimtareve të Serbisë.

sy të zbehtë  
nën gjethin e gjelbërt  
ferra të pjekura.

\*\*\*

çdo pranverë  
jorgavani paralajmlëron  
numërimin e pyllit

\*\*\*

i ngjanë barkës  
në qiell të ndryshueshëm  
muaji në mjegull

\*\*\*

fenerët e vegjël  
bartin në dritë  
khesat e mbrëmjes

\*\*\*

qetë buron  
nën cungun e ahut  
burimi në shkorret

\*\*\*

do tëffluturojë flutura  
në lulen e zgjedhur  
buqetë në varr

\*\*\*

kundërmon ftoji  
vijjë kujtimet  
nëna në mendime

\*\*\*

milionë pika  
nijagara e madhe  
bëjnë gjurmë

\*\*\*

pas vërshimit  
shkretëtirë në shtëpi në breg  
cunam drini

\*\*\*

në erë  
valojnë pelenat e abardha  
freskim në shtëpi





## **Marianne LARSEN (DANIMARK)**

Marianne Larsen u lind më 27.1.1951 në Kalundborg, Danimarkë. Pas arsimit shkollor studioi historinë krahasuese të letërsisë dhe kinezishten në Universitetin e Kopenhagës. Ajo përktheu poezi moderne kineze në danisht.

Në moshën 20 vjeçare pati debutimin letrar me vëllimin e poezisë Koncentracionier, që ia siguroi vendin si poete që

eksperimenton me gjuhën.

Para së gjithash është poete lirike. Ka shkruar disa vëllime me poezi. Më i fundit u botua më 2011, dhe quhet Sig mig et underjordisk træ med vindens udtale (Tregomë për një pemë nëntokësore me zërin e erës). Por, ka shkruar edhe disa romane, libra për fëmijë dhe drama.

Marianne Larsen është përkthyer në shumë gjuhë dhe ka marrë shumë çmime. Më 1989 mori bursën prestigjioze jetësore nga Statens Kunstfond. Ka udhëtuar shumë në veri dhe në pjesët e tjera të Europës, si dhe në Kinë dhe Australi. Jeton në Kopenhagë.

1)

### **JA KU JAM**

duke përqafuar ajrin  
me ty brenda  
kur jam e vetme

2)

### **DUKE MËSUAR PËRMENDSH**

Mëso përmendsh një flutur mbi kanatin.  
Strukturat e saj të shtrira prej krahu të bardhë.

Xhami sprapset prej saj.  
Flutura zhduket për në kopsht.  
Ngadalë xhami derdhet prapë-

Nuk mbetet asnjë gjurmë mbi kanatin  
e së pamundurës.  
Por e kam mësuar përmendsh.

3)

## KRAHË TË ZAKONSHËM NJERËZORË

e përqaftuam njëri-tjetrin  
 një palë krahësh të zakonshëm tatimpagues  
 njerëzorë  
 jo për t'i pushuar  
 por për t'i kalitur  
 një palë krahësh të zakonshëm të mësuar me be-  
 tonin  
 dhe me tregun, njerëzorë  
 një palë krahësh me nevoja të zakonshme  
 një palë krahësh me përqaftime të zakonshme  
 krahësh njerëzore  
 me ta e përqaftuam njëri-tjetrin  
 kanë sigurim shëndetësor dhe veshje të zakonshme  
 një palë krahësh me interpretim të zakonshëm  
 dashurie  
 krahësh njerëzore  
 sa të fortë qenkan  
 sovranë, të pavarur -  
 pa marrë parasysh ku  
 pa marrë parasysh në ç'ore  
 pa marrë parasysh në ç'stine  
 befaz dhe për gjithë kohën  
 krahë njerëzore  
 pa spekulim  
 me ta e përqaftuam njëri-tjetrin  
 si për të treguar që pafuqia e tyre  
 nuk ekziston



## Krystyna LENKOWSKA (POLONI)

Është poete, eseiste dhe përkthyesë e letërsisë angleze.

Deri më tani ka botuar shtatë libra me poezi. Në vëllimet e saj poetike hetojmë asociacione të vrullshme, fragmente imazhesh sa të dhembshme aq edhe tronditëse.

Është e përkthyer dhe e prezantuar me vëllime të veçanta poetike në SHBA,

Ukrainë, Gjermani etj.

Jeton dhe krijon në Rzeszów të Polonisë.

### VETMIA

Vetmia është vetëm një lidhje  
hapësirë  
prej deri tek  
prej njeriut tek njeriu  
prej njeriut tek vendi  
po para së gjithash  
prej vetvetes tek vetvetja

Më befason  
të paktën një herë në ditë  
se vetmia ime  
është në hapësirën  
prej teje tek unë  
prej deri tek

### TË UDHËTOSH DOMETHËNË TË JETOSH DYFISH

Të jetosh këtu ku ndjen aromën e të njohurit  
dhe ku gazeta e lënë mënjanë  
në anën e parë të botës  
dhe përveç këpucëve thuajse asgjë nuk ndryshohet

dhe atje ku gjithçka  
ndoshta befas mund të hedhësh të harrosh  
me përjashtim të natës dhe hijes

\* \* \*

Vdekja është gjë e natyrshme  
K.I. Gałczywski

Vdekja është e natyrshme si djepi  
të dyja janë mrekullira të mëdha të vogla  
në kohën e tanishme të bëra  
në mënyrë të përkryer  
ka nuk ka  
nuk ka ka  
ka provë fizike  
nuk ka asnjë dyshim

### **NIDZICA – OLSZTYNEK \***

Rreth e përqark  
retë davariten në mënyrë sinkronike  
sa çel e mbyll sytë  
kaleidoskopi i livadheve krijon modele të shkëlq-  
yera  
sot nga një diell bie dritë balsami  
si një milion vite më parë  
as zjarr nuk pati  
dhe bota nuk ishte e atillë  
dhe nuk do të jetë as nesër  
dhe nuk di mbase do të marr vesh  
pa lëvizje të Gishtit

\* Qytete në Poloni



## Xhuzepe NAPOLITANO (ITALI)

U lind në Minturno (Lt - Itali) në 12 shkurt 1949 dhe banon në Formia. Është i martuar me Irene Valonen, poete dhe aktore, kanë një vajzë, Gabrielën. I diplomuar për Letërsi në Romë, në 1972 me temën e diplomës mbi teatrin surrealist francez, Xhuzepe Napolitano ka dhënë mësim për 33 vjet letërsi italiane dhe latinisht në gjimnaze të ndryshëm.

Që nga viti 2006, drejton një kolanë librash të vegjël: "dhoma e poetit", në të cilën ka botuar, përveç se shumë libra të tij poetikë dhe me ese, edhe autorë të ndryshëm italianë të njohur dhe debutues, dhe sidomos përkthime të poetëve të Mesdheut, të panjohur më parë në Itali (francezët D. Leuwers, G. Drano, E. Burgos, A. Olive dhe N. Stamberg, spanjollët C. Vitale, A. Serna dhe G. Vega, tunizianët S. Nasr dhe R. Chehaibi, shqiptarët A. Tufa dhe Sh. Emërllahu, algjerianen S. Negrouche).

Në vitin 2008 ka themeluar shoqatën kulturore "dhoma e poetit" (ku është dhe president), me të cilën ka organizuar prej vitesh një festival ndërkombëtar poezie në jug të provincës së Latinës (në Komunitat e Itrit, Formias dhe Spinjos): "Zëra të Mesdheut". Në vitin 2011, Festivali u mikprit nga ekspozita ndërkombëtare "Yacht Med Festival", me 12 poetë që vinin nga 10 vende të ndryshme.

Botimet kryesore në poezi:

Çaste 1970; Brenda gjurmës 1978; Ma-skë 1978; Nëse te e nesërmja gjen pak të djeshme 1989; Krijesë 1993; Poezi / jo po-e-zi 1994; Fjalë fjale 1998; Zemër rëre 1998; Loja 1999; Ekuilibër i ndryshueshëm (përkthyer në spanjisht nga C. Vitale) 2000; Kalime (5 libra të vegjël), 2002; Sextines de Campodimele (përkthimi nga Nicole Stamberg) 2002; Bashkë me ty u lindi sërish 2003; Në bregun e kohës 2005; Fluturo lart, fjalë 2007; 10 poezi (përkthyer në gjermanisht nga R. Vecellio) 2008 dhe (përkthyer në shqip nga R. Salihu) 2010; Antologji (poezi 1967-2007 nën kujdesin e S. Di Spigno-s) 2009; Masa jetësore (përkthyer në spanjisht nga C. Vitale) 2009; Ditët e Naimit (përkthyer në shqip nga E. Zaimi) 2009; Genius loci (18 poezi për Normanno Soscian), 2009; Fletorkë 2010; Pastaj... (përkthyer në arabisht nga A. Youcef) 2010; Ditët e Tunizisë 2011; Shfaqja e sigurisë (përkthyer në frëngjisht nga G. Drano) 2007 dhe (përkthyer në arabisht nga A. Youcef) 2011. napolitano.giuseppe@ymail.com stanzadel-poeta.wordpress.com

## FJALË (E PASTAJ...)

Do të mbes (kur – “e pastaj?...” –  
prej meje prej fjalëve të mia  
të lodhesh vërtet) do të mbes  
ai i fjalëve – të shumtave  
fjalë që të thashë e të shkrova

e pastaj... do të pendohem se nuk dita  
të t’mbështes në vend se të flas  
e të shkruaj fjalë  
por faktet (faktet që  
– do ta doje një gjë të tillë? – do të tregonin  
një aftësi reagimi timen  
por kurrë të shfaqur haptas kur rasti  
e donte) nuk pata forcën  
t’i zbuloja – ku ishin fshehur?  
në palat e një bisede përherë in fieri

e pastaj... pastaj do të mbes ai i fjalëve  
të ëmblave, prekëseve, ngazëllyeseve  
thelbësoreve, të rrëmbyeshmeve fjalë  
të thëna, shkruara, pëshpëritura, përkëdhelura  
kushtuar zemrës sate ndjesive tua  
kushtuar asaj që qemë

– fjalët që do të të pengojnë atëherë  
njëmend të lodhesh prej meje

## 5 SHTATOR

Ti tash vjen dhe pritja që për sa vjet më rrejt  
se mund të bëja dhe pa ty,  
nës a përralla ëndrrat e mia mbi letër,  
tani më nxjerr një mburojë të brishtë  
dhe më propozon një përtej përtej vetes sime

Boll kohë do të duhet të ribëj tualetin  
dhe si i ri të dal para teje,  
pa dredhira me maskën më të bukur  
si në rrethanat e jashtëzakonshme  
por do të jem gati kur –  
dhe nuk dua të pres më gjatë  
– të më kërkosh dorën të të mbaj  
në dashç të të prij  
dhe dora ime do të të japë besim  
më të madh, në dorën tënde

Tani, ja pse një ditë duket sikur një  
tjetër që nuk është por është njësoj si t'ishte  
mu sikur ajo që më parë ish t'mos ishte  
– të jetë vallë një fëmijë?

## RIKTHIM NË SËTE

Të përshëndesin kuajt e bardhë  
të Kamargës dhe shkurret erëmuese  
në erë, të përshëndesin  
pishat e “Mas de Suède”  
dhe vreshtat e shtrembër ndën diell

Pa ty Seta duket paksa e trishtë  
– si ajo e dy kërricave  
fotografuar beftë në mes të zabullimës  
jopoetika e një dite që lodh

Të përshëndesin kodra të shogëta  
dhe fshatra ku koha pezull mbet',  
të përshëndesin luzmat shumëgjyrëshe  
të turistëve me pushime,  
dhe fytyrat e paqta të fshatarëve  
në pushimin e drekës në periferi:

është një pyetje e vazhdueshme për ty:  
ku je, pse s'je këtu?

Pa ty Seta duket më e trishtë.







## **Ekrem AJRULI (MAQEDONI)**

U lind më 1 shkurt 1957, në fshatin Sël-larcë e Epërme-Tetovë.

Është pjesëmarrës i disa manifestimeve letrare në vend dhe jashtë. Bashkëpunëtor i rregullt i revistave "Diogen prokul-tura" dhe "Maxminus".

Punon në Sh.B & Shtypshkronjën "Ar-bëria Design" – Tetovë.

Udhëheqës i sektorit të botimeve.

Ka të botuara këto përmbledhje:

- Marshi i demonëve - 1995;
- Rroftë e qoftë Lolestani - 2004;
- Kur qesh doktor Valuta-2007.

## **ALARM**

globi kollitet  
dridhet ka ethe zjarrmi  
sylugatët alarmojnë  
kujdes është pandemi  
nga erdhi vallë  
kush e di  
vërtet fajtorë janë shtazët  
apo e polli si çdoherë  
përbindëshi-NJERI  
kudo seanca-kongrese debate  
vampirë në frak të zi  
lëvizin institute klinika-qeveri  
gripi (H1N1)  
shpikje e derrave  
SURRATNJERI

## **KRROKAMË**

krrokamë horrash në verë  
krrokamë sorrash në vjeshtë  
zhurmë vertebrorësh  
që kurrë nuk heshtë  
krrokamë sorrash në mot me shi  
krrokamë horrash në mot me diell  
zhurmë bezdisëse që t'ngjallë neveri  
përzierje krokamëglasash  
kah do poshtë-lartë

mozaik fekalesh  
 kudo mbi parqe e asfalt  
 mbi degë të blirit pushojnë sorrat  
 krrrokama ngjall trishtim  
 nën hije degësh mrizojnë horrat  
 vallë ku e ka vendin SOJI IM.

## DO TË SHKRETA EPOLETA

Ndrit katundi anë e mbanë  
 Vajti terri erdhi mëngjezi  
 U gëzua tërë mëhalla  
 Se poet u bë Pekmezi  
 Shkruan vargje me shtërzim  
 Ca satira e parodi  
 Deklaron pa hezitim  
 Penë e parë jam në letërsi  
 I thotë gjërat shkurt e prerë  
 Për do të shkreta epoleta  
 Një poezi e boton shtatë herë  
 Çka nuk mban mjerë gazeta  
 Mer lapsin prej padronit  
 E vërsulet mbi fletore  
 Për ta ruajtur lezetin e fronit  
 Bën do vargje hamullore  
 Penën n'dorë si jatagan  
 E vringëllonë ditë e natë  
 Ku e din poet pekmezi  
 Se satira s'duron diktat

## BINI BURRA

Bini, burra, bini  
 Poshtë e lart pushtetit  
 Sa të mundni vidhni ripni  
 Në llogari t'miletit  
 Vërsuluni natë e ditë  
 Tryezave të rakisë  
 Burrërisht me besa-besë  
 Në llogari t'qeverisë  
 Le të çirret sa të dojë  
 Opozita anembanë  
 Edhe ajo është soji juaj  
 Mos e prishni sevdanë  
 Hani çka të mundeni  
 Veç salltanateve të miletit  
 Po i hëngrët dhe ato  
 Vjen dita e kijametit



## Subhransu PANDA (INDI)

U lind më vitin 1984 në Jeton në Bhubaneshvar, kryeqytetin e provincës indiane Odisha, Indi. Është poet, gazetar dhe krijues filmash. Ka botuar dy libra dhe ka xhiruar katër filma për çështje mjedisore. Me një përvojë rreth 6 vjeçare në mediet e shtypura dhe vizuale, ai ka dhënë gjithashtu një kontribut të konsiderueshëm si gazetar mjedisor. Shkruan për shumë botime periodike lokale për mjedisin, industrializimin çnjerëzor, erozionin bregdetar, letërsi, kulturë dhe çështje të jetës së përditshme. Ka bashkëpunuar me OTV (Televizioni i Odishës), SAMBAD, AROMV, PARYABEKHYAK etj.

Shkruan edhe prozë letrare, edhe poezi. Romani i tij i parë do të botohet këtë tetor në një revistë të Odishës. Ka botuar tashmë dy libra letrarë. Ka redaktuar edhe 3 revista letrare. Ka prodhuar emisionin "Koha letrare", një revistë televizive letrare në OTV. Në vitin 2008, kur u mbajt për të parën herë, mori pjesë në "Takimin e poezisë për poetë të rinj SAARC". Ishte indiani më i ri që gëzonte këtë mundësi për të këmbyer ide me homologët e tij nga vende të tjera të Azisë jugore. Është laureati i çmimit të shtetit të Qeverisë së Odishës për vitin 2007-08 për dorëshkrimin e tij "Gapa" me tregime të shkurtra.

Drejton po ashtu një shtëpi botuese: PEN IN.

Gjithashtu interesohet për filmin. Si krijues filmi, deri më tani ka bërë vetëm dy dokumentarë të vegjël. Është anëtar i Shoqatës së Filmit në Bhubaneshvar (FSB). Si gazetar përfaqësoi Odishën në Festivalin e 5-të të filmit për mjedisin dhe natyrën "CMS VATAVARAN" në tetor 2009. Në nëntor 2010 mori pjesë në "Punëtori informuese e medie të Azisë jugore për ndryshimin e klimës" në Nju Delhi.

Prej korrikut të këtij viti punon si ndihmës-menaxher për komunikim të korporatës në një projekt për një central elektrik.

Subhransu Panda jeton në Bhubaneshvar, kryeqytet të Odishës.

Adresa e korrespondencës: C-54, Prachi Enclave, Chandrasekharpur, Bhubaneswar-751016 Odisha, India; E-mail: subhransupanda@yahoo.co.in

## KJO ËSHTË RRUGA QË ÇON NË SHESH

Rrjedha e dy lumenjve po të ishte bërë njësh

Do të harronte udhën drejt detit

Kjo natë mos u mbaroftë kurrë.

Nuk di pse ti dukesh

Aq intime sonte

Kush mund të thuaj që posedon kur agon dita.

Nuk kam parë por errësira  
 Ka dëshmuar, se si kofshët e tua janë me pika  
 Kjo nuk më prish punë.  
 E qoftë vetëm për një natë  
 Luajmë rolin e dashnorit dhe të dashurës  
 Në këtë dhomë të infektuar me ëndrra.

Ylli i mëngjesit duket i çngjyrosur  
 Është kohë për të rregulluar flokët e tu  
 Mbjajë këtë katërqindpesëmbëdhjetshin  
 Të mbaruar dje.

Në rast se burrëria ime e zbehur do të njihet  
 Në dritën e ditës  
 Preferoj të mbaj një maskë  
 Kjo është rruga që çon  
 Në shesh.

Tani do të ndahem prej teje  
 Dikush do të ëndërroj natën e ardhshme  
 Si unë.

Në mungesën tënde  
 Do të ngrij në kujtimet e natës së uritur.  
 (2005)

(përkthyer nga odia në anglisht nga Sushant Mo-  
 hapatra, nga anglishtja në shqip nga Silke Liria  
 Blumbach)

## DITAR

Kur të zgjohesh  
 laje fytyrën tënde në dritë  
 endu nëpër qytetin që mbulon çarçafin e diellit

Mos e ha mendjen se a je i njohur apo jo  
 Bëhu i sigurt që qenke poet  
 Me këtë ekstazë, mbështetu mbi bankën prej çimen-  
 tos në stacionin e autobusit.  
 Hape gojën derisa të kënaqesh  
 dhe ofroi një këngë pëllumbit  
 të ulur vetëm në Krishnaçuda.

Ki një dhomë në park  
 Mblidhi ditët që kalove me të dashurën  
 Bregat le të fluturojnë  
 drejt horizontit.

Konkurro me hijen tënde  
poshtë poleve elektrike  
Dhe pusho pak kur bëhesh i tëhuar nga drita  
Duke u strehuar në një tub  
Bisedo me yjet deri vonë  
Pi nga pellgu aq sa mundesh.

Tash mund të kthehesh pa rrezik në shtëpi me qira  
Duke kërcyer përmbi gardhin  
Shko e fli gjumë para se dielli troket në derën tënde  
Përgatite ëndrrën tënde për nesër.

Kur të zgjohesh përsëri...

## LE TË ËNDRROJMË

Ëndrrat nuk kushtojnë asgjë

Pse derdhim lot në errësirë?  
Pse e fajësojmë fatin?  
Të lumtë janë ata  
që posedojnë hartat e  
ëndrrave të shkëlqyera

Madje shumëve u mungon një natë  
për të mbledhur ëndrrat e tyre

Para se të kërcejmë në shtrat  
le të përgatisim një ëndërr  
për nesër


A nuk mëson asgjë  
nga kjo errësirë?

Hesht  
Nata po intensivkohet  
Mëngjesi nuk është aq larg

Mëngjesi nuk është aq larg  
Duke mbajtur këtë ëndërr  
netët janë për t'u kaluar  
Sidoqoftë borxhet nuk largohen

Nuk ka rrugë të lënë mbrapa!

Le të mos digjemi për lumturi  
Më mirë të vrapojmë pas fluturave  
prej nesër...





## Hristo PETREVSKI (MAQEDONI)

Hristo Petrevski është lindur më 4 shkurt 1957 në Krushevë. Është themelues dhe drejtor i shtëpisë botuese "Feniks" në Shkup. Është anëtar i Shoqatës së Shkrimtarëve të Maqedonisë nga viti 1985. Një nga themeluesit e revistës "Stozher" dhe manifestimit "Praznik na lipite" (Festë e blirit) në SHSHM.

Tash është redaktor përgjegjës dhe kryesor i revistave "Trend" dhe "Knizhevna akademija" (Akademia letrare). Hristo Petrevski është magjistër i kulturologjisë në letërsi në Institutin e letërsisë maqedonase në Universitetin "Shën Cirili dhe Metodi" në Shkup. Është dhe docent në Universitetin ESRA në Shkup dhe doktorant në temën "Përralla autorësh-analizë krahasuese".

Libra me poezi për të rritur: "Pasqyra", "Nevojë vullkani" "Bisedë me muret" "Në luleshtrydhe krimb" "Maja", "Mburoja" "Trup i huaj" "Udhëtar në kthim" "Zabel" "Gjuhë gurore" "Çelës xhami" "Ngjyrë e bardhë" "Lexim i të pashkruarës" "Pantomimë".

Libra për fëmijë dhe të rinj: "Bonsai", "Të mençurve nuk u duhen shkallë për t'u ngjitur"

Prozë për të rritur: "Shitore në ajër të pastër", "Dreqi i mirë" "Piramida", "Labirint"

Prozë për fëmijë dhe të rinj: "Tramvaji i Shkupit", "Fshehtësia më e madhe", "Mirupafshim, Kenzo Tange", "Fëmija që dëshiron të jetë bletë"

Gjithashtu autori ka shkruar shumë ese dhe kritika, si dhe është i përfshirë në shumë antologji dhe përzgjedhje, ndërkaq është fitues edhe i disa çmimeve letrare.

## GABIM

Gabim është vetëm ajo që nuk është gabim.

Gabim është vetëm ajo për të cilën njerëzit vlerësojnë se nuk është gabim.

Gabim është që njerëzit vlerësojnë se ka diçka gabim.

Gabim është vetëm ajo që nuk mund të përmirësohet dhe përjetësisht mbetet gabim.

Gabim është vetëm ajo që nga Zoti është gabuar

Gabimi nuk është asgjë, mu për këtë shkak-as e gabuara nuk mundet të përmirësohet.

Gabim është e gjithë ajo që ka pamje virtuale dhe rregullohet.

Gabim është të mendohet se ka diçka gabim.

Gabim është të mos lindësh në kohë të gabuar dhe në vend të gabuar

I gabuar është njeriu që nuk është si dreqi i gabueshëm.

## NJERIU I GABUAR

Si mund ai të mos jetë AI  
Kur edhe ai është AI

Për të qenë ai AI  
Respektivisht të mos jetë AI DHE AI  
AI duhet të jetë dikush krejtësisht tjetër  
Ose i ngjashëm me të por prapëseprapë i ndryshëm.

Ashtu siç nuk ka dyshe në botë plotësisht të njëjtë  
Ashtu siç nuk ka dy gishta të njëjtë në duar dhe këmbë  
As sytë, vetullat dhe qerpikë nuk janë plotësisht të njëjtë  
Ashtu edhe AI është vetë, AI dhe plotësisht VETJA!

Në vend të fusnotës:

- 1) nuk ka njeri të gabuar
- 2) çdo njeri është i gabueshëm
- 3) njeriu i gabueshëm ec mbrapshtë
- 4) atë askush nuk e kërkon edhe ai askënd nuk kërkon
- 5) ai është dreq i vërtetë

## FILOZOFI E GABUAR

Mos jii filozof "i drunjtë"  
Mos ua sqaro zogjve këngën  
Qenve lehjen  
Peshqve heshtjen

Mos i pyet  
Ç'flasin gjinkallat  
Hipur lartë në dru  
(a do t'i zgjojnë ketrat)  
Derisa është vapë e padurueshme  
Ndoshta dhe qajnë, rënkojnë (përpëliten),  
Flasin  
Apo si muzikantë falas zbavitin (argëtojnë)  
Njerëzit!





## Diti RONEN (IZRAEL)

Diti Ronen u lind më 1952 në Tel Aviv. Është autorja e dy librave me poezi-Hënë e brendshme, bllokshënimesh(Hakibbutz Hame'uhad, 2002) dhe Kur shihe n brekët (Gvanim, 1999).

Poezitë e saj studiohen në institucione akademike dhe disa prej tyre u vunë në muzikë, u përshtatën për skenën, u përkthyen në gjuhë të huaja dhe u botu-

an në SHBA e gjetiu.

Ftohet rregullisht të bisedojë për poezinë e saj në Universitetin Bar-Ilan dhe në vende të tjera.

Dr.Diti Ronen u diplomua në Repartin e Arteve Teatrale, Shkolla e Arteve Vizuale dhe Interpretuese, Universiteti i Tel Avivit. Prej vitit 1999-2006 ishte kryetarja e Raporteve të Teatrit dhe Letërsisë në Ministrinë e Kulturës të Izraelit.

Momentalisht Ronen jep mësimë dhe këshillon për politikën e kulturës dhe administrimin e arteve. Është duke punuar edhe librin e saj të tretë me poezi, që synohet të botohet në vitin 2009.

\*

Ti lalesh në lumë  
dhe unë vij e zhytem pranë teje  
dhe uji që prek trupin tënd  
prek timin.

Asnjë fjalë nuk thuhet  
edhe shikimi është i heshtur.

Dhe një zog i zi i madh  
që duket si rojtar  
mbi një degë, i rregulluar mirë,  
nga ana e bregut,  
dëshmon dijen tone.

\*

Ti ecën pranë meje gjatë udhës  
që çon drejt pazarit  
dhe nga atje në banjot publike  
dora ime e djathtë prek tënden të majtë

Gjatë gjithë rrugës shkëmbejmë  
pikëpamje. Era

mban mbi ne një çadër dielli  
prej gjerësisë së vetëdijes.

Dhe ti je gjysma ime e dytë  
Dhe ti je gjithçka që unë nuk jam  
Dhe ti je gjithçka që dua  
Dhe ti nuk je, dhe unë jam me veten time.

Zemra ime është e tërë  
Me këdo që më përshëndet në paqe.

\*

Të pashë sot si më shikove  
një re e bardhë e vogël  
e vetme në këtë qiell të kaltër  
që ne rrethon tani të dy.  
Dhe ndonëse gjendeshe aq larg,  
shkove me mua në treg dhe mbajte shportat e mia  
Dhe erdhe me mua në shtëpi dhe hoqe sandalet e mia  
Dhe hyre me mua në dhomën time  
Dhe ishte pranë meje në orën e leximit  
Dhe vështrove mbi supin tim në orën e shkrimit  
Dhe më pyete: a do të më tregosh poezinë tënde të re?

Gjatë gjithë ditës mendova për ty duke pritur  
çastin e lindjes.

\*

Ti rri pezull mbi kopshtin  
ndërsa koha të bën me sy.  
Këdo që mbaje në krahët e tu  
mbetej e fshehur në dhomat e zemrës sate  
si pluhuri që u harrua  
në qoshen e shtëpisë:  
Vajza që unë kisha qenë  
Që u bë gruaja që isha  
Që më vonë u bë nëna  
Që u bë gjyshja -  
Ne të gjitha grumbullohemi tani  
Në një trup të ngjeshur.

E gjitha kjo bukuri  
si do të ta rrahë gjoksin  
kur do të zgjatësh krahët e tu  
drejt meje  
në një lëvizje pezulluese.



## Salajdin SALIHU (MAQEDONI)

Ka lindur më 26 maj 1970, në Tetovë. Ka doktoruar për letërsi në Universitetin e Shkupit. Ka botuar librat: Vdes pas gjërave të imëta (poezi dhe tregime, 1996), Panteoni i utopisë (ese, 1997), Nata e parë e pushtimit (poezi dhe tregime, 1998), Gjurmë (ese, 1999), Gënjeshërë e sinqertë (poezi, 2004), Natë e blertë vetmie/Zelenata noc na

samosta (poezi, 2005),

Digresione (ese, 2008), Vonë për gjëra të turpshme (poezi, 2009), Digresione II (ese, 2010)

Është bashkautor i librave: Edhe ne dëshmojmë - We witness (shqip-anglisht) – publicistikë (1996), i antologjisë së The likuid sun, SPE (2003), Tecno sonce, MPS (2003), i publikimit Roli i komunikimit në integrimet rajonale dhe globale, (2008), i librit Gazetaria –Njohuri të përgjithshme, (2009). Përkthyes i librit të Izet Sarajliqit, Përmbledhja sarajevase e luftës (2004). Është fitues i disa çmimeve për letërsi: Çmimi “Serembe” 2008 për libër më të mirë me poezi; “Qiriu i Naimit”, 2008 etj. Poezitë dhe shkrimet e tij janë përkthyer në disa gjuhë dhe janë përfshirë në antologji dhe panorama të ndryshme. Punon pedagog në Universitetin Shtetëror të Tetovës.

## POETËT VIJNË ME VONESË

“Poezia është armë e mbushur me të nesërme”

Gabriel Selaja

Në orë poetike vriten zogj frymëzimi...

Poetët vijnë me vonesë.

Atdheu i tyre është e nesërmja.

Më parë duhet të takohen me të pavdekshmit e botës tjetër.

Pastaj do të vijnë që të takohen me të pavdekshmit e së nesërmes.

Zakonisht shpejtojnë kardinalët e kuq krekosësh,

që duken si fëmijë

dhe kënaqen me lodrat që vetë i kanë sajuar.

Lejojnë t’i tallin me buqeta lëvdatash

dhe dekorata publike...

Poetët vijnë me vonesë...

Dhe kurrë s’e mësojnë se kanë ardhur...

## GRUA E LARGËT, E AJËRT

O grua e largët, e ajërt,  
 që t'u luta të më falje një puthje,  
 "puthje hyjnore, kumbuese të butë si pëlhurë",  
 në një natë të trishtë,  
 rrahur nga depresionet,  
 në një natë të brishtë,  
 të heshtur plot ofshama;  
 O grua që bredh nëpër botë  
 e lodhur nga një humbje,  
 që mjeshtërisht e fshehje dëshpërimin,  
 që si një Triptolem më ushqeje me qumësht hyjnor;  
 O grua e largët, e ajërt,  
 me buzë të brishta,  
 ku flenë puthjet e lehta si ajri,  
 të lehta si vdekja;  
 puthjet krahëthyera që vdesin qetësisht,  
 të pa shijuar nga një burrë që kthehet në bishë;  
 O grua e largët,  
 o dashnore e shfrenuar,  
 bishtpërdredhur që dukeshë dhe shpirtin kishe bosh,  
 që flirtoje me hije për të mbytur kotësinë  
 dhe të vërtetën më të shndritshme që dije ta mohosh;  
 O grua e largët, a hije e frikshme,  
 sirenë që ftoje një shpirt rebel për ta vrrarë...  
 Odise nuk isha as veshët s'i mbyllja,  
 po s'mundesha të rrëfeja për gjithçka kisha parë;  
 O grua e largët, grua e afërt,  
 që flirtoje me natën dhe ëndërroje një tejbotoë,  
 ti zonjë Bovari që s'gjeje qetësi  
 ti nuk e di,  
 jo ti nuk e di,  
 se sa trishtim ke derdhur në botën time,  
 se sa zogj ke trazuar nëpër pyje mendimesh,  
 se sa peshq ndriçues ke trazuar në thellësitë e detit shpirtëror...  
 O grua e largët,  
 me gji plot zjarre të fjetur,  
 rrahur prej dëshpërimesh,  
 gruaja e një hijeje tjetër...

## VONË PËR GJËRA TË TURPSHME

Desha të shkruaj poezi dashurie  
 Të të thosha se të kam ëndërruar lakuriqe  
 Dhe dy gjinj mbështetur në duar  
 Se si klithmat tua m'u përplasën në fytyrë

Si sytë e mi të mbyllur të panë  
 Si pastaj ca si sfurqe m'u ngulën në shpatulla  
 Teksa bija në një hon  
 Ashtu, me muskuj të tendosur...  
 E pastaj pashë veten  
 Të lodhur  
 Të vetmuar  
 Në një krevat me çarçafë të linjtë  
 Ku mungonte fryma jote  
 Trupi i paqhtë  
 Desha pastaj të shkruaja...  
 Oh...  
 Por tani jam shumë serioz  
 Për të shkruar gjëra kaq të turpshme...

## PRINDËRIT

Frikacakë të pashërueshëm.  
 Bota gjithmonë u duket e egër  
 Dhe fëmijët u duken të pakujdesshëm...

## NJË PIKË DETI DERDHET NGA SYTË E MI

Muzg ngjyrëjargavani.  
 Anije që dremisin mbi kaltërsi ujore dhe alga zhgënjimi.  
 Vasha të largëta.  
 Vasha të mjegullta.  
 Puthje të jodizuara.  
 Hije të dashurish ikur prej vitesh në botën e përtëjme...  
 Deti - ikonë.  
 Unë - mëkatari.  
 Deti - joshja e një femre fatale;  
 syri i një vashe,  
 ku ankorojnë anije të mjegullta  
 dhe fluturojnë pulëbardha të ëndërta...  
 Jam i vetëm dhe i trishtuar...  
 Një pikë deti derdhet nga sytë e mi.

## KUR FLEN

“Më pëlqen dashuria që është si gjumi”

D.H. Lawrence

E fjetur  
e zhveshur  
nga gjithçka tokësore  
frymon qenia jote  
në kohë hyjnore

## DUA GJITHÇKA QË LIDHET ME EMRIN TËND

I dua ato rrugë të gjata, të frikshme  
që të ftojnë si prostitutat të zhytesh në çmendinë e  
tyre...

sepse ti ke ecur nëpër to...

I dua ato pemë mbuluar me trishtim,  
të kanë bërë hije kur jashtë ka bërë vapë...

E dua këtë qytet të rrezikshëm dhe të frikshëm,  
ku mund të t’vrasin papritur  
pastaj të kërkojnë ndjesë për vrasje të paqëllimtë...

sepse ti jeton atje

O Diotimë e një Helderlini tragjik,

ku banon poezia,

e freskët si vdekja aksidentale,

që mban vetminë përdore

dhe shfaqesh papritur në muzgun ngjyrëjargavani,

që ec e vetmuar

dhe flet heshtazi me stinët...

e dua gjithçka që lidhet me emrin tënd.



## Kristiana Dobreva STANKOVA (BULLGARI)

Ka lindur në Qytetin Sliven të Bullgarisë. Shkollën e mesme e kreu në "Dr.Ivan Seliminski" në qytetin e lindjes (me mësim në gjuhën ruse), kurse shkollimin e lart në Universitetin "Shën Klimenti i Ohrit" në Sofje, magjistre e gjeografisë.

Vargjet e saj i ka publikuar në shumë almanah si në: "Zhazhda", "Irin Pirin", "Poeti 2005", "Sillovesa", "Gllasovi od Mellnik", "Vezni" dhe në shtypin periodik. Në vitin 2006 botoi përmbledhjen poetike "Sepse të dua", në vitin 2007 botoi përmbledhjen poetike "Më pi ngadalë", në gjuhën maqedone, kurse në janar të vitit 2009 përmbledhjen poetike "Lulja e kaltër".

Ka marrë shpërblime në konkurse të shumta poetike si në: radio "Veselina", "Për një botë më njerëzore" (2004), "Mbrëmjet poetike të Mellnikut" (Mellnishki veçeri na poezijata) (2006), "Iskri nad Bjalla" (2010), "Dobroslov" (2010), "Pred olltara na svobodno sllovo" (2010).

Është redaktore e disa përmbledhjeve poetike. Jeton dhe punon në Sliven të Bullgarisë.

## KUPTIMI

Pa kufi largë dhe pa kufi afër  
jetojmë këtu në botën absurde  
dhe kërkojmë mënyrë që ta gëlltisim faktin,  
se çdo ditë është një hap drejt vdekjes,  
por nuk ka mundësi se si Kohës  
t'a lidhim flatrat me litar hithëre  
dhe në fakt tregoni a din dikush  
në ç'drejtim koha rrjedh  
në çdo çast fluturon pa kthim  
dhe në çdo lindje, lind perëndimi i ri,  
dhe çdo dashuri është pikë kthyesë  
në jetën e mundimshme të dikuj  
dhe sa gjatë apo sa shkurtër  
vuajmë për dashurinë e përjetshme,  
e cila lind disi spontanisht,  
e pastaj na rrëmben përjetësisht.  
Cili është kuptimi i ditëve të numëruara...,  
por ne jemi të lumtur çdo cast,  
ku një gllënjikë ajër kemi marrë  
dhe në atë gllënjikë fshihet Bota.

## MUNDËSIA

U përpoqa të jem poetike,  
por dhimbja në shpirt më ndaloi  
dhe fjlët nuk e kanë kuptimin e tyre,  
dhe tragjet në rërë humbasin  
dhe nuk ka rrugë për kthim prapa,  
do të kërkojmë anije gjatë ditëve të shkretuara,  
sigurisht do të takohemi, por për shkurt kohë,  
ashtu sikurse fare nuk kemi jetuar  
në këtë botë të papërsosur pa dashuri,  
pa gabime dhe drejtime të braktisura.  
Të të falë për mua është mundësi  
të të dashuroj pa qenë e tmerrshme.

## QETË

A ke fjalë për mua?  
Nga tuat plot heshtje.  
A don të më ftosh?  
Këtu jam një pëllëmbë largë.  
A mund të të dëgjoj?  
Madje heshtja është e shurdhët.  
Ishte dashuri përplot me tinguj.  
Sot thjesht është e qetë.

*Përktheu nga origjinali: Adem Abdullahu*





## Haxhi SHABANI (MALI I ZI)

Haxhi Shabani lindi, më 9 qershor 1963 në Anë të Malit-Ulqin. Shkollën fillore dhe të mesme e kreu në Ulqin. Fakultetin Filozofik, Degën e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe e kreu në Prishtinë, më 1987. Gjatë studimeve për sukses të shkëlqyeshëm shpallet "Student i Dallur".

Me krijimtari letrare filloi të merret qysh në shkollë të mesme, gjatë fillimit të viteve të tetëdhjeta, duke botuar fillimisht poezi në revistën "Koha" që botohej në Titograd (Podgoricë). Në studime në Prishtinë botoi poezi në revistat: "Zëri i rinisë", "Bota jonë", "Fjala" etj.

Interesimin për punën shkencore e filloi gjatë viteve të fundit të studimeve (1986/87), duke botuar artikuj gjuhësorë në "Bota jonë" e "Zëri i rinisë". Diplomoi në vitin 1987 me temën "E folmja e Anës së Malit në sistemin fonetik e morfologjik", duke u vlerësuar me sukses të shkëlqyeshëm.

Pas përfundimit të studimeve botoi leksikon e frazelogjinë gjuhësore nga Ana e Malit dhe Ulqini si dhe artikuj gjuhësorë për bilingvizmin në Ulqin dhe Tuz në revistat "Gjuha jonë", "Studime albanologjike", "Rilindja", në Prishtinë dhe "Shkodra ndër shekuj" e "Buletini shkencor" në Shkodër, "Fati" e "Lemba" në Ulqin.

Gjithashtu analizoi nga aspekti dialektologjik-gjuhësor tekstet e shkrimtarëve bejtexhinjë nga Ulqini: Ali Riza Ulqinakaku dhe Hysejn Bushati. Mori pjesë në takime të ndryshme shkencore si në Prishtinë, Ulqin, Shkodër etj.

Kreu studimet pasuniversitare në vitin 2006 në Fakultetin Filologjik, Degën e Gjuhës shqipe duke mbrojtur magjistraturën shkencore me titullin "Dyngjuhësia te shqiptarët e Ulqinit" te mentor akademik Rexhep Ismajli.

Në vitin 2007 botoi librin "Rrezikimi i gjuhës shqipe" ("Për dyngjuhësinë te shqitprët e Ulqinit") në shtëpinë botuese "Toena" nga Tirana".

Në fushë të krijimtarisë letrare botoi dy përmbledhje me poezi: "Të kërkoj" (1995) dhe "Natë e portokalltë" (1998). Është përfshirë në përzgjedhjen e shkrimtarëve shqiptarë në Mal të Zi "Dritaren lëre hapur", botuar nga Art Club, në vitin 1998. Është përfshirë po ashtu në vëllimin poetik përzgjedhës në shqip e anglisht "Manifestimi letrar ndërkombëtar Ditët e Naimit 2000". Në takimin ndërkombëtar letrar "Ditët e Naimit" që organizohet në Tetovë, në vitin 2001 për poezinë "Amerika më merr më të mirë" shpërblehet me çmimin e parë "Qiriu i Naimit".

Në fushë të gazetarisë nisi të botojë qysh në fillim të studimeve në fakultet. Intenzivisht me gazetari merret qysh në fillim të viteve të nëntëdhjeta. Ishte korrespondent i disa gazetave, revistave e

agjencive nga Prishtina. Pastaj gazetar, lektor e redaktor i disa revistave nga Ulqini dhe i Radio Ulqinit. Qysh në vitin 1998, punon gazetar-korrespondent nga Ulqini në Redaksinë Shqipe të Televizionit të Malit të Zi. Në televizion realizoi disa portrete dokumentare si për shqipëruetin e "Biblës", dom Simon Filipaj dhe për ndihmesën e Bajram Rexhës në arsim, kulturë, politikë etj.

Që nga hapja e Fakultetit të Mësuesisë në gjuhën shqipe në vitin 2004 në Podgoricë është asistent i lëndëve fonetike e fonologji dhe morfologji e gjuhës së sotme.

Nga viti 2007 është kryetar i Shoqatës së Krijuesve Art Klub nga Ulqini e cila është organizatore e vepërimitarive letrare, kulturore, shkencore dhe botuese.

## SYTË E TU NDRYSHOJNË NGJYRË

Kur të shikoj, kur s' më shikon  
 Kur më vështron kur s'të vështroj.  
 Shikim yt i pikëlluar me flet  
 Ai është më i thellë se loti  
 Më i zëshëm se qarja  
 Dhe s' di se kah shkon  
 ajo e kaltërta e gjelbërt  
 e syve tu?  
 Tashmë ata sy pushtohen  
 nga e hirta gri.  
 Dhe nuk e di si duron  
 Dhe nuk e di si duroj  
 Të mos qajmë së bashku  
 për pikëllimin tënd.  
 Kur t'i shoh ata sy  
 Kur më shohin ata sy  
 E shoh shikimin tënd të hazdisur  
 Kur vetëm në momente e ngazllyer je  
 Si shkëlqejnë tash ata sy.  
 Sytë e tu përsëri ndryshojnë ngjyrë  
 Tashmë e mugëta e muzgut  
 I vesh me një vello mistike.  
 Tash vetëm ëndrra i shpëton.  
 Sytë e tu tash kanë ngjyrën e diellit  
 Dhe të hënës bashkë.

## KUJTOMË

I.

Edhe kur të jem midis shkretëtirës  
Me shpirtin e tharë  
Duke ngritur rërën e përflakur përpjetë  
Me pëllëmbët e përvëluara  
I etur për sytë e tu  
KUJTOMË!  
Se do të çahet qielli  
Nga sytë e tu  
Do të pikojë ujë burimi  
Nga ata sy qielli.  
Unë atëherë do të ngrihem  
Më shpejt se Feniksi  
Do të të gjej  
Kudo që ke shkuar  
Kudo që je zhdukur  
Kudo që je strukur  
REMEBER ME .

II.

Edhe kur të jem  
Midis ujëdetit  
Midis ujqeanit  
Kur trupi im i gjatë  
Për peshkaqenët  
S'do të dalë as për një kafshatë  
KUJTOMË!  
Se ata nga babëzia e të ngrënit  
Sytë s' do t'm'i hanë  
Unë gjithsesi  
Kudo që të jesh do të vij  
Të të përkëdhel me sy  
Ke shijuar ndonjëherë ledhatimin e syve?  
Do t'ja filloj nga ndarja e flokëve  
Pastaj me sytë e mi  
Do t'i kreh sytë e tu me dritë.  
Aty, ti e di, do të bësh pak vend  
Për sytë e mi që të pushojnë pak  
Nga shikimet mishngrënëse  
REMEBER ME.

III.


Edhe kur të jemi  
Në rrugët e ndryshme të qiellit  
Ti në njëren galaktikë  
Unë një një tjetër galaktikë

## KUJTMË!

Edhe i djegur në qofsha  
Nga përcëllimi i diellit verbues  
Unë do të vij se s'bën  
Për të kujtuar  
atë prekjen time të lehtë  
mbi ndarjen e flokëve  
në kokën tënde të molltë  
Ato prekjet tuaja trupore  
Nuk e di me dashje a padashje  
Ato detajet e veshjes tënde  
Që të mbështjellin trupin  
Me valëzim të brendshëm  
REMEBER ME  
Sepse vetëm për këtë  
Jam i gatshëm të vdes  
Të ringjallem dhe përsëri të vdes.

## MAGJI

O sa kam nevojë të braktis  
Burgun e njëtrajtshmërisë  
Burgun e përditshmërisë  
Të pushtohem nga liria e magjisë  
Që ma dhuron ti.  
Atje, në atë magji  
Vetëm shi i ngrohtë bie  
Mbi dy qeniet tona  
Të bëra avull.  
Ne avullojmë  
Vallëzojmë vallen e valë  
Të vibrimeve të venave.  
Kjo valle  
Veç me sy të mbyllur  
Vallëzohet  
Duke u çliruar  
Nga çdo gjë e tepërt.  
Kjo valle  
Vallëzohet  
Trup për trup  
Shpirt për shpirt  
Eshtë për eshtë.  
Nuk shoqërohet  
Me asnjë fjalë  
Me asnjë melodi.  
Ajo ka emrin magji.



## Primo SHLLAKU (SHQIPËRI)

U lind më vitin 1947 në Shkodër. Ka kryer Gjuhën dhe letërsinë shqipe në Fakultetin Histori – Filologji në Universitetin Shtetëror të Tiranës. Ka dhënë mësim në institucione të ndryshme të arsimit të ulët dhe atij universitar.

Ka botuar librat: Lule nate (poezi), 1994, Hana e njelmët e ditës (poezi), 1995, Edhe fjalët shkojnë në ferr (poezi), 2005, Kosova - Saga e Ballkanit (reflek-

sione, me bashkautor), 2002, Nji Uliks që s'mbrritti kurr në Itakë (Martin Camaj), 2006, Lule nate (ribotim i zgjeruar me shënime), 2008, Fleurs de nuit (2009), botim në Francë nga shtëpia botuese Bien-être

Ai ka përkthyer një sërë librash të autorëve të njohur si: Charles Baudelaire, 'Lulet e së Keqes', Jean-Paul Sartre, 'Baudelaire (monografi sprovë për një psikologji ekzistencialiste), Gotthold Ephraim Lessing, Laokoon (Mbi kufijtë mes Pikturës e Poezisë), André Gide, L'immoraliste, (roman), Omar Khaiam, Rubairat (nga frëngjishtja me konsulent persian), Jean-Paul Sartre, Zaret u hodhën (skenar filmi), Diomed Vllahu, Far stuhie (poema) nga greqishtja e re, Arshi Pipa, Politika gjuhësore në Shqipërinë socialiste (monografi për ShNjL)

Jeton në Tiranë.

## DHURATË (II)

Po të dhuroj

heshtjen e malit

dhe një lule kryeulët,

që s'pati kohë me sajue aromën.

Kjo lule zemrohet nëpër erë

dhe s'mundet me ikë

Po ta dhuroj pa aromë,

vetëm të dridhun nëpër erë,

me besë se aroma dhe dridhjet

janë motra

të ktij qielli indigo

që një dardhë në lule

andrron për vete

ditën e dasmës së vet

kur bletët i munguen.

## S'KA MÂ HYJ

S'ka mâ hyj  
 që kputen netve të gushtit  
 e bien  
 mbi pllambën e pritjes.  
 Mes nesh ka vetëm shi,  
 shi kambëngulës,  
 që shtrin horizontin.  
 Edhe kur të vijë moti i mirë,  
 edhe kur të dalë vera,  
 dielli do të jetë i ftoftë  
 e drita e tij e lagët.  
 Mund të jenë veç do lule të vogla,  
 çilun para kohe,  
 aq para kohe,  
 sa s'mundën me pasë aromë.  
 Ky shi e për lau të tashmen  
 dhe unë vetëm të kam dashtë...  
 Me dashtë nëpër shi  
                                   është e pamundun...  
 Me jetue nëpër shi  
                                   domethanë mos me të takue  
 kurr në të tashmen.  
 Ke ikë nëpër shi  
 dhe shi do të jesh bâ.

Razna, 13.04.2011

## VIZITË

Shkova  
 në të gjithë vendet  
 ku ndëjtëm.  
 Karrikja jote ishte ftoftë.  
 Bishta cigaresh të spërdredhun  
 flenin një gjumë të marrë  
 në një shtrat prej hini.  
 Brrylat e ty  
 s'e kishin gungue tavolinën  
 e fjalët tona  
 i kishte mbledhë me fshesë  
 një kamarier.  
 Kjo është e para herë  
 që një fjalë e imja  
 nuk e përndezi lulkuqen.  
 Kjo e para

që nuk bâhem kthesë e lumit  
dhe qielli nuk âsht mâ  
nji kmishë e freskët puplini,  
hekurosë me avull.  
Pra ftyrën s'ta mbaj mend...  
Trupi yt u zhdodh  
e ra prej timit,  
kurse mbi dysHEME  
uji i harresës ngurron me u tha.  
Në betejën tonë kundër kohës  
do t'i humbas krahët,  
gjymtyrët do t'i humbas  
dhe nji vit kryemadh  
do të na shtypë  
si faraon.

Tiranë (te Paulini) 16.05.2011







## Agron TUFA (SHQIPËRI)

Agron Tufa u lind në 1967 në Sohodoll, Dibër. Studioi për letërsi në Universitetin e Tiranës dhe në Institutin Gorki të Moskës. Më pas kreu studimet pasuniversitare në Institutin e Kulturave Evropiane, po në Moskë, ku mbrojti masterin në përkthim letrar, për krijimtarinë e Josif Brodskit. Është poet, shkrimtar, përkthyes dhe studiues, si dhe profesor i Letërsisë së huaj të shek. XX, Teorisë së

përkthimit dhe rrymave letrare në Universitetin e Tiranës, Fakulteti Filologjik. Ka mbrojtur gradën Doktor i Shkencave Letrare me punimin "Mistika e Origjinalit", sërish në lëmë të përkthimit.

Veprat e tij janë: Aty tek portat Skee (1996), Rrethinat e Atlantidës (2002), Avangardë engjëjsh (2005), Fryma mbi ujëra (2007), Gjurma në rrjedhë (2010), romanet Dueli (1998), Fabula Rasa (2004) për të cilin u nderua me çmimin kombëtar Pena e Argjendtë, Mërkuna e Zezë (2006) dhe Tenxherja (2009), me të cilin ka fituar çmimin "Rexhai Surroi" për romanin më të mirë shqiptar në Kosovë; po ashtu, ka shkruar përmbledhjet me ese Janusi qindfytyrësh (2004), Kuja e Mnemozinës (2010), Thembra e Akcilit (2009) dhe veprën monografike Dibra me sytë e të huajve (2008). Në shkurt 2010 është nderuar me Çmimin e Madh Kombëtar për veprën letrare në Shqipëri.

## MËNGJESI

I

Mëngjesi hyn me një karrocë dore,  
dyst me pupla e sy të pulitun zogjsh,  
me mjegullën e pezull të gjumit

nga dhoma në korridor.

Karroca e dorës avitet ngadalë nëpër mjegull.

Fantazmat largohen me gjepte miqësore,

fluturojnë palë-palë në trajta rrobash

të palosen padukshëm në mjegullën

që përvidhet ndën derë, platitet qoshesh,

shuhet nën presionin e ujit në lavaman.

Ku treti kështu gjithë ai panair fantazmash

multiplikative?

II

Zgjimi është një elektrik dore

me bateri, thuajse të skaduara,

sa memzi lëshon dritë në retinat

e mpira të syve mes puplash në karrocë.

Lepuj e demonë, trajta ekcentrike,

antropomorfe, surreale

tërhiqen në formacion të rregullt  
nën zilen e muzikës së zgjimit.  
Është dikush, i padukshëm, që e shtyn  
karrocën me sytë e fjetur mes puplash.  
Është dikush që i shpupurit puplat gjumashe  
dhe foleza shpërgjomet gugatjesh, përçafjesh.  
Kaçurrelat e tij janë nginjur aroma fëmijësh.  
Mirëmëngjes Mëngjes! Më vjen keq  
t'i shkund thërrimet me sklepa,  
gjurmët e puthjeve, mbresën e çapokut  
të ngrohtë të mëllenjave në faqe.  
Keq më vjen ta shprish trajektoren ritmike  
të rrahjes së gjakut në zemër.  
Mëngjesi. Karroca me pupla gjumashe.  
Sy të rimtë e gugatje! Mirëmëngjesi -  
familja ime dadaiste!

\* \* \*

O djalë i sheqertë e sytrishtë!  
Të lumen ditë e sose mbi kryet e babit të sëmurë!  
O djalë i bardhë, rrezëllor, re puplore mbi shtrat -  
pendë vezulluese engjëlli  
që trazon veshtullinë e mugët të dhomës së ngime  
n'ilaçe.  
O vogëlush engjëllor, sahat fosforeshent xhepi  
para syve të mi! Djalë i fildishtë, more, me emër të  
hareshëm -  
kush ta kalli hijen e idhtë në gjak?  
Asgjë e keqe me babin s'ka me ndodhë;  
i lodhur është babi dhe pak i mërzitun,  
thjesht malli e ka marrë me u ankue pak,  
sall me kthy n'vedi një grimë e me bujt  
shmangas prej botës me zhurma shkallmuese...  
Paj romantikës vend tjetër s'i mbet, pos tek sëmund-  
ja.  
Dëgjomë, vogëlushi im sykallajtë:  
merr më mirë borinë e verdhë tek lodrat e tua  
dhe fryji... fryji t'avyten si kancona t'ambla motrat  
rreth teje,  
për dysheme ta ulin, gjallë prej kubeje  
afreskun me engjëjt fiorentinë.

Ka me mbriritë atëbotë ma i nalti prag i sëmundjes  
dhe kamomili i bebëzave të tua  
s'ka me e pasë thjerrzën e zezë në zemër të gonxhes.

\* \* \*

A do ta dimë ndonjëherë vallë  
ç'gjësend është i denjë  
për këngën e trishtë të gjërave?

E trishta këngë e gjërave  
rrëshqet nën lëkurë.  
Pranitë e padukshme  
ngaherë i shpërfillim  
dhe humbim përditë  
mes objekteve kaba  
ku kënga na rëndet; shkërmoqet motivi...


Mes keqkuptimesh na rritet pendesa  
për epoka jetime, pa përjetim.  
Keqardhjet tona tash u bënë pengje  
dhe kurrë më s'do ketë për ta ngushëllim.

\* \* \*

E dashura qau ndaj të gdhirë, pa zë,  
dhe lotët i shkisinin, rrokulliseshin për faqe,  
dhe supet i dridheshin me ngashërime.  
Ishte e shtunë shtatori të vonë,  
gjethet e para qenë futur nën prag;  
të tjera, të pezullta, lakoheshin në ajër.  
Ishte ditë pushimi dhe një mendje më thosh  
me marrë arratinë ku mendja s'kish bujtë.  
Por e dashura dëneste dhe dielli s'kish lindë,  
qe veç ndaj të gdhirë shtatorit të vonë...  
Nuk e dija shkakun, as ngushëllimin...  
ndaj gishtat e mi kërkoni me instinkt  
ndofarë enigme mes flokëve të saj.  
Në gjoks ia marr kokën, i pëshpërij në veshë  
ninulla t'palindura për pyje të largët  
ku trokthi i kuajve shuhet në myshk,  
ku ndihet veç tingulli i dhëmbëve  
të shqarthëve  
që zhvoshkin prej drurësh lëvoren e njomë.  
E dashura pushoi, me gjasë po dremiste  
në paqen që fal gjumi i ri.  
Të mbramet fjalë,  
ndërsa kridhej në gjumë,  
i rrëzoi si fletë  
në puhizën e lehtë.  
Si pezm a si mall,  
unë rri e i mbledh nëpër dhomë kuturu:

"Ç'bëhet atje, larg, me fëmijninë time gege...?  
Po me gjuhën e dashtun, kush na ftohu kështu?"

Ishte ditë shtatori të vonë... Malli dëneste  
në vetë të parë.





## Ndue UKAJ (KOSOVË)

Ndue Ukaj është shkrimtar, kritikë i letërsisë dhe publicist. U lind në vitin 1977 në Stubëll të Epërme të Komunës së Vitisë. Ka kryer studimet për letërsi dhe gjuhë shqipe në Fakultetin e Filologjisë në Universitetin e Prishtinës, ku ka ndjekur edhe studimet e magjistraturës. Në Suedi ka ndjekur kurse të gjuhës dhe kulturës suedeze. Ka qenë anëtar i disa redaksive letrare. Po ashtu, ka qenë editor i revistës për art, kulturë e shoqëri "Identiteti" që është botuar në Prishtinë. Është i përfshirë në disa antologji të poezisë shqipe, brenda dhe jashtë. Poezitë dhe tekstet e tij janë përkthyer në anglisht, rumanisht, spanjisht dhe italisht. Është autor librash me poezi dhe studime letrare. Ndërsa libri *Godo nuk vjen*, u laureua me çmimin kombëtar "Azem Shkreli" për librin më të mirë të botuar me poezi në vitin 2010 në Kosovë.

### **GODO VJEN**

Mos qajë furishëm, Godo vjen  
Furtuna ka pushuar, e rruga nga Irlanda është e kalueshme  
Ai ka zbutur shikimin e trazuar dhe zemërimin akilian  
Edhe dhembja e gjoksit i ka pushuar.  
Ai vjen nën Pemën e Jetës.  
Ku e ke krijuar follenë e pritjes  
Me një kënetë dëshirash t'lidhuna lak.

Godo vjen me muzikën e detit plot heshtje  
Pritja jote e ka trimëruar,  
Ai vjen me thesin plot enigma,  
Pranë Pemës që është kalbur  
Ku ti pret me i fut duart e dridhuna  
Që t'i kafshoi ironia e pritjes se pafundme.  
Dhe fjalët që ndërronin trajtë çdo mëngjes.

Sythi yt i blertë si beson kohës, as pritjes,  
...e as ardhjes së tij.  
Me dushkun e pemës thur kurorën e fitores. Sa gëzim.  
E me shpresa të reduktuara deri në mosbesim, tret shikimin  
Dhe kalon nëpër lumin e rrëmbyeshëm pa u vërejtun.  
Papritur kthen rrugën në gjysmë.  
Ulesh me mërrola zjarrndriçuese afër e më afër Pemës  
Ku dritat e bardha ta thithin shikimin e përmalluar.

Ku ruan nostalgjinë e pritjes.  
 ...hapin e zemrës.  
 Nëpër gishtërinjtë e lodhur numëron teatrin absurd-  
 eve  
 Me aktor të lakuriqësuar pranë t'cilëve  
 Spektatorët janë shpërndarë në meridianët e vdekjes.  
 Duke e pritur Godonë.  
 Dhe frikën nga gjarpri nëpër trupin e pemës së kalbun,  
 Që frushkullon pa nda.  
 Eh pra, Godo vjen, pritja jote e ka trimëruar.  
 Pranë Pemës së Jetës  
 Me trupën e aktorëve me ndërtua  
 teatrin e shpëtimit për ty.  
 Dhe kohën e pritjes që zgjat sa ardhja e tij.

## GODO ERDH


Është natë, bubullimat s'kanë t'ndalun  
 Të dridhet trupi i lagur nga shiu i rrëmbyeshëm  
 Nën Pemën e Jetës duke pritun Godonë.  
 E pritja t'ka shndërruar në statujë moderne.  
 Ku folenë e jetës e kanë korbat  
 e natës e zogjtë vetmitar.

Vetmia jote është strukur si gjarpër i lidhur  
 Mes së cilit përbirohet gjuha e tij helmuese.  
 Papritur dëgjohet një e trokitur e furishëm, ti se dëgjon.  
 Veshët t'janë mbyllur nga krimba që ngjiten trupit tënd.  
 Si plakut para Derës së Ligjit  
 në tregimin e Franc Kafkës.  
 Pret t'hysh në misterin e Ligjit, më fal, të Godos  
 desha me thanë.  
 Me kuptua misteret e abuzurditizmit të barasvlershme  
 Me ato të dehumanizimit.


Zot im,  
 Godo erdhi, me shikimin e mërrolur dhe thesin e shqyer,  
 Me dëshira të humbura gjatë rrugës së gjatë të  
 kthimit  
 Nën Pemën e Jetës, ku e prite pafundësisht.

Ti se njohe,  
 E ai erdhi me trajtat e një fytire  
 që se kishe imagjinuar kurrë.  
 Me zërin e lodhur që se kishe dëgjuar kurrë,  
 Me shikimin e trazuar që se kishe parë kurrë.  
 Trishtimi të shtang trupin. Krimbat përplasën tokës









## Gustavo VEGA (SPANJE)

Gustavo Veg u lind më 1948 në León, Spanjë. Eshtë doktor për filologji spanjolle nga Universiteti i Barcelonës, i diplomuar në filozofi në Universitetin "Shën Thomas Aquinas" në Romë, në filozofi dhe arte (specializim filozofi) në Universitetin e Barcelonës dhe në pedagogji në Universitetin e León-it. Teza e doktoraturës: Poéticas de Creación Visual en España, 1970-1995 (Poetika të krijimit pamor në Spanjë, 1970-1995).

Flet për shumëfishmërinë e poezisë së tij pamore: ideografike, kaligrafike, shkronjore, konkrete, hapësinore, video-poezi, poezi tridimensionale -- poezi-objekti ose poezi-skulpture, poezi-instalimi, poezi-veprimi etj.

Vega, njëri nga ushtruesit kryesorë të poezisë pamore në Spanjë, u lind në León, por prej vitit 1972 banon në Barcelonë. Është i specializuar në kërkim teorik, pedagogji dhe veprimtari krijuese në tri fusha: filozofi, poezi dhe artet plastike. Tri disiplina, të cilat Vega i kombinon dhe shpesh sintetizon në veprat e tij duke arritur një grupim të përkryer nga elemente letraro-poetike dhe arti plastik. Si artist plastik dhe poet pamor ka pasur ekspozita të veçanta në Spanjë dhe Argjentinë dhe ka marrë pjesë në më shumë se njëqind ekspozita grupore.

Vega është autori i veprave *Habitando Transparencias* (Duke banuar tejdukshmëritë) (Barcelonë: Àmbito Literario, 1982), *El Placer de ser* (Kënaqësia e qenies) (Madrid: Ed. Endymion, 1997), *Prólogo para un Silencio* (Parathënie për një heshtje) (Barcelonë: Ed. Zendera Zariquiey, 2001), *La Frontera del Infinito* (Kufiri i të pakufizuarit) (León: Kolek. Palabra & Imagen, Universiteti i León-it, 2005), *Plaça del Bonsuccés* (Plaza del BuenSuceso) - Talleres de Creación Poética en Barcelona- (Punëtori poezie në Barcelonë) Madrid: Ed. Libertarias, 1994) dhe shumë libra në formatin "folio" me poezi pamore dhe ndërdisiplinore: *Al límite del instante* (Në skajin e çastit), *Teoría-81* (Teoria-81), *3x3-3* etj. Ka themeluar dhe e drejton grupin *Ex.Tensión Fonética* si dhe *Laboratorio de Investigaciones Poético-Fonéticas* (Laboratorin për kërkim poetiko-fonetik), që ka mbajtur shumë referate në rajonin e Katalonisë. Si pjesë të veprimtarisë së tij pedagogjike ka mbajtur seminare, kurse dhe punëtori për shkrim krijues në Spanjë si dhe në Amerikën Latine. Për disa vite dha mësim në historinë e artit në Universitetin e Barcelonës si dhe mësim të poezisë pamore në Universitetin e León-it dhe institucione të tjera.

## DUHET TË DIMË

Ti, unë  
                                 duhet të kemi një lloj deti  
 prej gurësh në damarët,  
  
 një thikë me sustë të ngecur në  
   kujtesën tonë,  
                                 një rreze absurde dielli  
 që ndriçon mosqenien tonë  
  
 ose, nëse jo, më thuaj pse  
   ëndrrat tona gjithmonë  
                                 rrëshqasin nëpër  
 gishtërinjtë tanë.

Duhet  
     të gjejmë pse  
                                 i gjithë ky ndryshk, e gjithë kjo harresë  
     na e zverdh vështrimin  
 duke ikur gjithmonë nga  
  
 vetja jonë.

## PA SHENJA

Ti e kërkon veten  
                                 në mes të çakllit të  
 dritës sate të rënë  
  
 në asfalt.

Ti e kërkon  
                                 veten por gjen vetëm pasqyra  
 pa imazh,  
  
 pa imazhin  
 të cilin e pret.

Ti e kërkon veten  
                                 por vetëm e gjen lotin  
 të cilin e varrose.

Ti e kërkon veten por  
   ëndrrat e tua thyhen  
 kundër kohës.

Ti e kërkon veten por...  
Dhe do të vazhdosh të kërkohsh, ta kërkohsh  
veten duke vdekur.

## LODÉVE / FESTIVAL, 2006

Francezi thotë OUI  
Portugezi thotë SIM  
Spanjulli thotë SÍ

Rusi thotë DA  
Arabi thotë NAÁM  
Egjipciani thotë AYWA

Shqiptari thotë PO  
Hebren thotë KEN  
Okcitani thotë OC

Maltezi thotë IVA  
Anglezi thotë YES  
Berberi thotë YAH  
Gjermani thotë JA

Maqedonasi, serbi,  
kroati, malazezi  
thonë DA

Persiani thotë BALEH  
Turku thotë EVET

Gjeorgjiani thotë KI  
Italiani thotë SI  
Katalani thotë SÍ  
Unë them SÍ

Por ti... thua JO  
Ti thua JO  
JO





## **Këze Kozeta ZYLO (SHBA / SHQIPËRI)**

U lind në Tepelenë. Pasi diplomohet në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" për Gjuhë dhe Letërsi (1979), punoi si mësuese e Letërsisë Shqipe dhe botërore në disa gjimnaze të Tiranës, ndërkohë kryen dhe studimet pasuniversitare në Universitetin e Tiranës.

Merr pjesë aktive në krijimin e Partisë Demokristiane të Shqipërisë dhe që nga themelimi ishte në Kryesinë e saj.

Në vitet 1994-1995, u zgjodh Sekretare e Përgjithshme e Partisë Demokristiane të Shqipërisë, si dhe drejtoante gazetën "Ora e Shqipërisë". Në shkurt të vitit 1997, me shpërthimin e trazirave social-politike në Shqipëri, emigron në ShBA (New York), ku integrohet në shoqërinë e atjeshme, vazhdon kualifikimet në kolegji, emërohet Këshilltare e studentëve në BramsonORT College (2000-2004). Ka botuar në gazetën "Illyria" në USA. Është bashkëpunëtoreshë në TV "Kultura Shqiptare" dhe pronare e TV Alba Life, New York. Ka botuar librat me poezi: Monumenti i Lotit (2005), Pranverë pa Mimoza (2006), Mjellmat po të vijmë (2008), Një fjongo dielli nga New Yorku (2010), Refleksione shpirtërore (kritikë, ese, reportazhe) (2010).

Ka punuar sekretare për shtypin dhe informacionin në Shoqatën e Shkrimtarëve Shqiptaro-Amerikanë. Punon në Bordin e Edukimit në Nju Jork.

### **E FUNDIT QË JEP SHPIRT...**

Zërin se kam bilbil, të të këndojë mbi degë,  
As si i ëmbli Naim, të të mjekojë buzën e çarë,  
Por po të fal sythin e fjalës, që çel në pranverë,  
Dhe Hënën tek parku, që të prët me aq mall.

Dhe shfaqesh ti pranë pemëve të heshtura,  
Me vjeshtën e florinjëtë, që gjethet rrëzon,  
Në kujtimin e bukur, lotëve të patretura,  
Brenda gjoksit të Hënës, veç ti qëndron.

E mbështjellë kujtimin me të butin mëndafsh,  
Dhe vesh pemën e zhveshur, nudo nga vjeshta,  
Si shenjtore e heshtur, mes kopshtit qëndron,  
E fundit që jep shpirt, është vetëm shpresa!

Manhattan, 1997

## NË SHPIRT I KISHJA FSHEHUR

Dhimbshëm u ndava nga shkronjat ILIRE,  
Të huajat më prisnin udhëve të mundimshme,  
Në shpirt i kisha fshehur, me mallin e Hënës,  
Dhe një unazë antike të nënokës sime...!

Lotova pa ndalur ndarjen me klasën,  
Dhe s'munda të duroja përlotjen e tyre,  
Në shtegtim iu mora të ëmblat kujtime,  
Dhe hartimet përgjysmë: "Kthehuni Dallandyshe"

Me dënësë përqafova fisniket kolege,  
Zemrat si zogth filluan të dridheshin,  
Në pikturë Rembrandti një lot u kthye,  
Dhe dhimbjet tona pikë-pikë digjeshin...!

Dhe vitet fluturojnë, e pazonja t'i ndal,  
As penën në shqip që shkruan në kartë,  
Ndërsa brenga e kthimit më gërryen ngadalë,  
Dhe hartimet përgjysmë, që s'ja u ktheva prapë...

Manhattan, 1998

## NJË VARKË HËNE

Pranverë të tyltë më hodhe supeve,  
Me frymën tënde që lehtaz e prek,  
Një fashëz hëne butë të puth syrin,  
Që si nuse e bukur zbret nga retë

Barisim të dy në ajër të dehur,  
Si pëllumba paqeje në të bukurin qiell,  
Kjo mbrëmje e prushtë kujtimet ka krehur,  
Dhe si me magji në shtëllunga i tjerr...

Dhe mund të duket kjo, një romancë e bukur,  
Brenda qiellit të ëndrrave, që s'shuhen kurrë,  
Nga liqeni i syve ca pikëza loti rodhën,  
Dhe me buzët e tua m'i fshive ti gjithë nur...

Dhe s'besoj të jetë ky i fundit ëndërrim,  
Që me krah magjie i bie botës rreth,  
Ndërsa një varkë Hëne më bën strehim,  
Bashkë me Yllin tim që me aq mall e pres!

New York, 2000

## PËRMBAJTJA

- Craig CZURY (SHBA).....9**  
ARTICULITUS TË NDRYSHËM  
VELENXË E BARDHË  
MES LUTJES DHE ZGJIMIT  
PRA, NË FUND MBETET PERCEPTIMI  
HAP NJË HESHTJE TË TMERRSHME MES NESH  
E SHTUNA E VDEKUR  
ÇDO DITË NJË KËRKIM LEGJENDAR PËR BRIT-  
MËN E HUMBUR
- Ivan ANTONOVSKI (MAQEDONI).....23**  
KËRCNIM POROSI, ZGJIDHNI VET  
MESHA DERI TE NJË QEN  
AKOMA E PRES
- Mohammed el AMRAOUI (MAROK / FRANCË)..29**  
FOTOGRAFI
- Ag Apolloni (KOSOVË).....33**  
AVENUE  
RETORIKA E HESHTJES  
ZOMB
- Ana BAGËRJANA (UKRAINË).....39**  
FILLIMI  
PËRAFËRSISHT AJO ËSHTË ATJE...  
ERA U HESHT
- Jan BAEKE (HOLANDË).....41**  
ANA E VERËS  
E SHPIKA  
HARI THOTË
- Samira BEGMAN (ZVICER).....45**  
ENDËS  
E VETME, SHUMË LARG NJËBRIRËSHIT
- Richard BERENGARTEN (ANGLI).....51**  
KUR AJO KËNDONTE NË BULEVARDIN E  
BARDHË  
NUMËRIM  
VOLTA  
Ç'THA ORAKULLI I DELFIT

- Silke Liria BLUMBACH (GJERMANI).....55**  
 DASHNORË - FANTAZMA  
 DUKE NOTUAR NËPËR OQEANIN PAQËSOR  
 SHKUPI
- Charles FLORES (MALTA).....57**  
 FESTË  
 DËRRASË TRAMPOLINI  
 DRU I SJELLË NGA DETI  
 KOSOVA
- Shaip EMËRLLAHU (MAQEDONI).....61**  
 TROJA E KALIT  
 NATA E PISTË  
 MOLLËT E TETOVËS
- Sabahudin HAXHIALIÇ  
 (BOSNJË DHE HERCEGOVINË).....63**  
 MARGARITAS ANTE PORTAS  
 URTËSI  
 LEHTËSIA E PAHARRUESHME E SHPRESËS
- Lulëzim HAZIRI (MAQEDONI).....65**  
 HOMAZH PËR BABANË  
 NJË GJETH ÇAJI MBAJ NË GOJË  
 AJO MË USHQEN
- Delvina KËRLUKU (MAQEDONI).....69**  
 LODHJE  
 NË LUFTË ME VETEN  
 BISEDË ME VETEN
- Nevena KOKANOVIÇ (SERBI).....71**
- Marianne LARSEN (DANIMARKË).....73**  
 JA KU JAM  
 DUKE MËSUAR PËRMENDSH  
 KRAHË TË ZAKONSHËM NJERËZORË
- Krystyna LENKOWSKA (POLONI).....75**  
 VETMIA  
 TË UDHËTOSH DOMETHËNË TË JETOSH DY-  
 FISH  
 NIDZICA – OLSZTYNEK \*
- Xhuzepe NAPOLITANO (ITALI).....77**  
 FJALË (E PASTAJ...)  
 5 SHTATOR  
 RIKTHIM NË SËTE



<b>Ekrem AJRULI (MAQEDONI)</b> .....	<b>81</b>
ALARM	
KRROKAMË	
BINI BURRA	
<b>Subhransu PANDA (INDI)</b> .....	<b>83</b>
KJO ËSHTË RRUGA QË ÇON NË SHESH	
DITAR	
LE TË ËNDRROJMË	
<b>Hristo PETRESKI (MAQEDONI)</b> .....	<b>87</b>
GABIM	
NJERIU I GABUAR	
FILOZOFI E GABUAR	
Diti RONEN (IZRAEL).....	<b>89</b>
<b>Salajdin SALIHU (MAQEDONI)</b> .....	<b>91</b>
POETËT VIJNË ME VONESË	
GRUA E LARGËT, E AJËRT	
VONË PËR GJËRA TË TURPSHME	
PRINDËRIT	
NJË PIKË DETI DERDHET NGA SYTË E MI	
KUR FLEN	
DUA GJITHÇKA QË LIDHET ME EMRIN TËND	
<b>Kristiana STANKOVA (BULLGARI)</b> .....	<b>95</b>
KUPTIMI	
MUNDËSIA	
QETË	
<b>Haxhi SHABANI (MALI I ZI)</b> .....	<b>97</b>
SYTË E TU NDRYSHOJNË NGJYRË	
KUJTOMË	
KUJTOMË!	
MAGJI	
<b>Primo SHLLAKU (SHQIPËRI)</b> .....	<b>101</b>
DHURATË (II)	
S'KA MÂ HYJ	
VIZITË	
<b>Agron TUFA (SHQIPËRI)</b> .....	<b>105</b>
MËNGJESI	

- Ndue UKAJ (KOSOVË).....109**  
GODO VJEN  
GODO ERDH  
PËRCIPTAZI
- Gustavo VEGA (SPANJË).....113**  
DUHET TË DIMË  
PA SHENJA  
LODÉVE / FESTIVAL, 2006
- Kozeta ZYLO (SHQIPËRI/SHBA).....117**  
E FUNDIT QË JEP SHPIRT...  
NË SHPIRT I KISHJA FSHEHUR  
NJË VARKË HËNE

Boton  
Manifestimi Letrar Ndërkombëtar  
"Ditët e Naimit"  
Tetovë

Drejtor  
Shaip EMËRLLAHU

Lektor  
Ekrem AJRULI

[www.ditetenaimit.org](http://www.ditetenaimit.org)

Botimin e ndihmoi  
Ministria e Kulturës e R. Maqedonisë

U shtyp më vitin 2011, në shtypshkronjën  
"ArbëriaDesign", Tetovë.

CIP - Katalogizimi në publikim  
Biblioteka popullore dhe universitare 'Sveti Kliment Ohridski',  
Shkup

KËNGA E DETIT / (Përgatiti: Shaip Emërllahu; përktheu: Silke  
Liria Blumbach);  
Manifestimi Letrar Ndërkombëtar 'DITËT E NAIMIT', - Tetovë,  
2010; 136 f.; ilustr. 21cm.- (Biblioteka 'Meridiane poetike')

ISBN 978-608-65084-2-5  
Emërllahu, Shaip

COBISS.MK – ID 84928778

